

Në bazë të nenit 9, paragrafi (3) të Ligjit të Mundësive të Barabarta të Femrave dhe të Meshkujve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 6/12,166/14 dhe 150/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 53/21), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 26 korrik 2022, miratoi

## STRATEGJI PËR BARAZI GJINORE 2022-2027

### HYRJE

Strategjia për Barazi Gjinore 2022-2027 (në tekstin e mëtejme: Strategjia ose SBGj-ja) është dokumenti strategjik themelor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili krijon kornizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve për promovimin e barazisë gjinore dhe promovimin e statusit të femrave.

Strategjia është miratuar për periudhë prej gjashtë vjetësh, nga 2022 deri në 2027, dhe është dokumenti i katërt strategjik në këtë fushë.

Strategjia nisat nga vlerat themelore të rendit kushtetues: sundimi i së drejtës, humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti dhe respektimi i normave të pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërnacionale. Ajo udhëhiqet nga klauzola kundër diskriminimit në gëzimin e lirive dhe të drejtave themelore, e përcaktuar në nenin 9 të Kushtetutës, sipas të cilit: "qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të barabartë në liri dhe të drejta, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja nacionale dhe sociale dhe bindja fetare, statusi pronësor dhe shoqëror. Miratimi i Strategjisë rregullohet me Ligjin e Mundësive të Barabarta të femrave dhe të meshkujve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 6/12), e cila parashikon miratimin e Strategjisë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 9, paragrafi (3) i Ligjit të Mundësive të Barabarta të Femrave dhe të Meshkujve) me propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 10, paragrafi (2) i Ligjit të Mundësive të Barabarta të femrave dhe të meshkujve).

Miratimi i kësaj strategjie edhe njëherë vërteton angazhimin dhe përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për avancimin e të drejtat njerëzore të femrave dhe të meshkujve dhe për krijimin e mundësive të barabarta për femrat dhe meshkujt në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Gjithashtu ky dokument strategjik bashkon aktivitetet në të gjitha fushat e veprimit për arritjen e barazisë gjinore.

Miratimi i këtij dokumenti do të thotë konfirmim i realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Programin e Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2020-2024, të cilat i referohen çrënjosjes së stereotipave dhe paragjykimeve, parandalimit të dhunës në bazë gjinore, promovimit të statusit të femrave në bujqësi si dhe vlerësimit të potencialeve për lidërship të femrave.

## PROCESI I PËRPILIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia u përpilua përmes procesit që ishte i hapur për pjesëmarrjen e të gjithë faktorëve që shprehën interes.

Procesi i hartimit të Strategjisë u ndoq nga Vlerësimi i Progresit dhe Ndikimit të Strategjisë Nacionale për Barazi Gjinore (SNBGJ) (2013 - 2020) dhe Planit Nacional të Veprimit për Barazi Gjinore (PNVBGJ) (2018 - 2020). Të dy aktivitetet janë komplementare dhe përfshinin një proces konsultimi dhe bashkëpunimi mes ekspertëve dhe grupit të punës, të cilët ishin të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e të dy aktivitetëve, si dhe faktorëve të tjerë në fushën e barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Konstatimet nga Vlerësimi i Progresit dhe Ndikimit të SNBGJ-së 2013-2020 dhe SNBGJ-së 2018-2020 përfshihen në objektivat dhe rezultatet e pritshme të Strategjisë.

Strategjia bazohet në parimet e ligjshmërisë, publicitetit, transparencës, përgjegjësisë, llogaridhënies dhe bashkëpunimit ndërsektorial.

## KORNIZA JURIDIKE E STRATEGJISË

### Korniza juridike ndërnacionale

Republika e Maqedonisë është Veriut është nënshkruese e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Pekinit (1995), e cila angazhohet për përmirësimin e statusit të femrave dhe forcimin e tyre në jetën publike dhe private. Gjithashtu, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrave (CEDAV) është nga dokumentet kryesore mbi të drejtat e femrave dhe në përputhje me detyrimet e saj sipas kësaj konvente, Republika e Maqedonisë së Veriut dorëzoi raportin e saj të gjashtë periodik në vitin 2017, dhe Komiteti publikoi konkluzionet dhe rekomandimet e tij në vitin 2018. Ato janë pjesë e qëllimeve dhe aktivitetëve strategjike të kësaj Strategjie.

Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë së Veriut është vend kandidat për anëtarësim në BE, kjo strategji konfirmon edhe një herë respektimin dhe promovimin e standardeve dhe praktikave Europiane për arritjen e barazisë gjinore. Në këtë drejtim, duhet përmendur se direktivat dhe rekomandimet e BE -së për kuadrin për mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt zbatohen në legjislacionin e brendshëm. Me këtë, vendi ynë ka përmbushur detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit.

Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e Këshillit Europian (KE) dhe i ndan përpjekjet e KE-së për të siguruar një nivel adekuat të mbrojtjes sociale, veçanërisht për kategoritë më të cënueshme të qytetarëve. Prioritetet strategjike të Strategjisë së Këshillit të Europës për Barazi Gjinore 2018 - 2023 fokusohen në parandalimin dhe luftimin e stereotipave gjinore dhe seksizmit, parandalimin dhe luftimin e dhunës në bazë gjinore, qasje të barabartë në drejtësi për femrat, pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe të meshkujve në miratimin e vendimeve, mbrojtje të të drejtave të femrave dhe vajzave azilkërkuese, emigrantë dhe refugjatë dhe integrimin e politikave gjinore në të gjitha politikat dhe masat. Republika e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në hartimin e Strategjisë së Këshillit të Europës përmes përfaqësuesve të saj në Komitetin për Barazi Gjinore të Këshillit të Europës.

Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Femrave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) është dokument gjithëpërfshirës në fushën e dhunës ndaj femrave dhe kjo paraqet bazë dhe detyrim veçanërisht në aktivitetet që synojnë njohjen, parandalimin dhe mbrojtjen e femrave dhe vajzave nga dhuna dhe dhuna në familje. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ishte ndër vendet e para që ratifikoi Konventën e Stambollit në vitin 2017, pas së cilës filloi procesi i zbatimit të saj.

Në vitin 2015 të gjitha vendet anëtare të OKB-së kanë miratuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të cilat ofrojnë udhëzimet kryesore për prosperitetin e përgjithshëm, paqen dhe zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha vendet. Qëllimi 5 i Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm është "Arritja e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimi i të gjitha Femrave dhe Vajzave" dhe trajton në mënyrë konkrete arritjen e barazisë gjinore duke futur masa për të arritur qëllime për avancimin e pozitës së femrave në botë. Qëllime konkrete për avancimin e pozitës së femrave në botë janë:

1. Të anulohen të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe vajzave kudo;
2. Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, eksploatimin seksual dhe forma të tjera të shfrytëzimit;
3. Të eliminohen të gjitha dukuritë e dëmshme, si martesat e detyruara me fëmijë, martesat në moshë të re dhe gjymtimi gjenital i popullatës femërore;
4. Të njihet dhe të vlerësohet kujdesi i papaguar dhe detyrat e shtëpisë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale dhe promovimit të përgjegjësisë së përbashkët brenda ekonomive familjare dhe familjeve, sipas rrethanave nacionale;
5. Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet në vendimmarrje në jetën politike, ekonomike dhe publike;
6. Të sigurohet akses universal në të drejtën për shëndetin seksual dhe riprodhues në përputhje me Planin e Veprimit të Konferencës Ndërnacionale për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Platformën e Pekinit për aksion dhe dokumentet që rezultojnë nga këto konferenca;
7. Të ndërmerren reforma për akses të barabartë të grave në burimet ekonomike, si dhe akses në tokë dhe forma të tjera të pronësisë, shërbime financiare, trashëgiminë dhe burimet natyrore, në përputhje me ligjet nacionale;
8. Të rritet aplikimi i teknologjive që sigurojnë kushte më të mira, veçanërisht në fushën e informacionit dhe komunikimit për të promovuar emancipimin e gruas;
9. Të miratohen dhe përmirësohen politika dhe akte të shëndosha për zbatimin e tyre me qëllim përmirësimin e barazisë gjinore dhe emancipimin e të gjitha grave dhe vajzave, në të gjitha nivelet.

Në vitin 2018, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përmes Këshillit Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm, përcaktoi pesë OZHQ -të prioritare (1, 4, 8, 13 dhe 16). Në vitin 2020, Qeveria e publikoi Anketën e parë Vullnetare Nacionale (AVK) mbi përparimin e vendit në arritjen e OZHQ-ve nga Agjenda 2030.

Në vitin 2020 Korniza për Bashkëpunim për Zhvillim të Qëndrueshëm u nënshkrua midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kombeve të Bashkuara 2021 - 2025, me të cilën orientohet puna e agjencive të OKB -së në vend për 5 vitet e ardhshme. Në Kornizë siguron udhëzime konkrete për progresin në përputhje me dokumentet nacionale të zhvillimit të harmonizuara me OZHQ -të dhe të drejtën e BE -së.

Perspektiva Gjimore është pjesë përbërëse e Konventës Kornizë të OKB -së për Ndryshimet Klimatike si dhe Preambulën e Marrëveshjes së Parisit (2017), duke theksuar se kur ndërmarrin aktivitete për të adresuar ndryshimet klimatike, palët duhet të respektojnë dhe promovojnë të drejtën për barazi gjimore dhe forcimin e femrave. Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve e këtyre dokumenteve, në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale (MPPS) është emëruar person përgjegjës nacional për gjini dhe ndryshimet klimatike.

Në vitin 2020 Republika e Maqedonisë së Veriut u bë anëtare e NATO -s, duke u zotuar kështu për zbatimin e parimit të integritimit gjinor në të gjitha politikat dhe masat që lidhen me paqen dhe sigurinë, domethënë zbatimin e plotë të Rezolutës 1325 dhe politikat e NATO -s për femrat, paqen, dhe sigurinë. Agjenda për "Femrat, Paqen dhe Sigurinë" u prezantua për herë të parë në vitin 2000 me miratimin e Rezolutës 1325, dhe tani përfshin nëntë rezoluta shtesë (1820,1888,1889,1960, 2106, 2122,2422, 2467 dhe 2493).

### **Korniza juridike nacionale**

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, çështjet e barazisë gjimore nga pikëpamja normative rregullohen me Kushtetutë, me ligj të veçantë, përkatësisht me Ligjin e Mundësive të Barabarta të femrave dhe të meshkujvedhe përfshirjen e perspektivës gjimore në ligje të tjera.

Ligji i Mundësive të Barabarta të femrave dhe të meshkujve (LMBFM) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 6/12) u miratua për herë të parë në vitin 2006 u ndryshua më tej në vitin 2012. LMBFM siguron kuadrin kryesor ligjor, i cili rregullon çështjet e barazisë gjimore. Me të rregullohen masat themelore dhe të veçanta për krijimin e mundësive të barabarta për femrat dhe meshkujt, si dhe kompetencat, detyrat dhe detyrimet e subjekteve përgjegjëse për krijimin e mundësive të barabarta, procedurën për vendosjen e trajtimit jo të barabartë të femrave dhe të meshkujve, si dhe të drejtat dhe detyrat e Përfaqësuesit për mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt. Në kohën e përgatitjes së kësaj Strategjie, po përgatitet Ligji i ri i Barazisë Gjimore, i cili përpiqet për harmonizim më të madh me standardet, kërkesat dhe direktivat ndërnacionale.

Në vitin 2020 u miratua Ligji i ri i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 258/20), i cili është një mjet i rëndësishëm në trajtimin e diskriminimit të shumëfishtë dhe ndërsektorial me të cilin përballen femrat.

Në 2019 u miratua Ligji i ri i Mbrojtjes Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/19) me të cilin bëhet reformë e të gjithë sistemit të mbrojtjes sociale për përbushjen më efektive të nevojave të qytetarëve, ndër të cilat femrat dhe vajzat nga kategoritë e prekshme zënë një vend veçanërisht të rëndësishëm.

Në vitin 2021 u miratua Ligji i ri i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Dhuna ndaj Femrave dhe Dhuna në Familje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 24/21) me të cilin zgjerohet sistemi i parandalimit dhe mbrojtjes nga të gjitha format e dhunës me bazë gjimore dhe në familje, në pajtim me standardet e Konventës së Stambollit.

Ligji i Familjes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012, 44/2012, 38/2014, 115/2014, 104/2015 dhe 150/ 2015) e përcakton moshën minimale për martesë, të drejtat dhe detyrimet prindërore, të drejtat për shkurorëzim.

Me ndryshimet në Kodin Zgjedhor (Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 196/15) në vitin 2015 u prezantua një kuotë prej të paktën 40% e përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e kandidatëve të partive, me atë që në çdo tre vende në lista së paku një vend është për gjininë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese së paku një vend në çdo dhjetë vende.

Me ndryshimet në Ligjin e Marrëdhënieve të Punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 74/15) në vitin 2015 rregullohet paga e barabartë për femrat dhe meshkujt dhe trajtimin e barabartë në lidhje me punësimin, orarin e punës, kushtet e punës, skemat e sigurimeve shoqërore të punës dhe mungesën nga puna. Gjatë përgatitjes së Strategjisë, po hartohet Ligji i ri për Marrëdhënie Pune, i cili do të harmonizohet me Direktivën e BE -së për të Drejtat Prindërore dhe futjen e mungesës prindërore për meshkujt.

Me Ligjin e Rrogës Minimale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 11/2012, 30 / 2014, 180/2014, 81/2015, 129/2015 dhe 132/2017) në vitin 2017 hendeu gjinor në rroga u zvogëluar duke barazuar rrogën minimale për punëtorët në industrinë e tekstitit, lëkurës dhe këpucëve, ku shumica e punonjësve janë femra.

Ligji i Mbrojtjes nga Shqetësimi në Vendin e Punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 79/13), i cili është në fazën e ndryshimit në kohën e hartimit të Strategjisë, synon të "parandalojë dhe mbrojë kundër shqetësimeve psikologjike dhe seksuale në vendin e punës [...] dhe të sigurojë një mjedis të shëndetshëm pune".

Në vitin 2019 u miratua Ligji i ri i Ndërprerjes së Shtatzënisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/19), që paraqet përfitim të madh për të drejtat riprodhuese si një postulat i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në mënyrë plotësuese, me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/2016) garantohet qasja në kujdesin shëndetësor për të gjitha femrat.

Me Ligjin e ri për Ndhmën Juridike Falas ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/19), në fushën e ndihmës juridike parësore, midis tjerash, janë përfshirë viktimat e dhunës në bazë gjinore dhe dhunë familjare, si dhe ndihmë në procedurën e regjistrimit në regjistrin e lindjeve, marrjen e dokumenteve të identifikimit personal dhe shtetësisë, procedurën për mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, pensionin, aftësinë e kufizuar dhe sigurimin shëndetësor, etj.

Ligji i ri i Arsimit Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 161/19), u miratua në vitin 2019, i cili ndalon çdo lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në arsimin fillor, masat afirmative janë parashikuar në mënyrë që të kapërcehet diskriminimi dhe të promovohet barazia. Në vitin 2018 u miratuan ndryshimet në Ligjin e Librave Shkollorë për Arsimin Fillor dhe të Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015,

217/2015, 30/2016 dhe 21/ 2018) me qëllim të redaktimit dhe rafinimit të mëtejshëm të procedurave dhe procedurave për botimin dhe sigurimin e teksteve shkollore në shkolla ku nuk do të ketë përmbajtje të dëmshme diskriminuese dhe stereotipa.

Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13 dhe 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 42/20), i kushton vëmendje të veçantë përfaqësimit të barabartë gjinor dhe etnik në organet vendimmarrëse të medieeve. Me ndryshimet e vitit 2018, Ligji parandalon, ndër të tjera, diskriminimin në media bazuar në gjininë, seksin, orientimin seksual, identitetin gjinor dhe përkatësinë në grup të marginalizuar.

Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/ 11, 142/12, 166/12, 55/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14 dhe 132/14), në vepra të dënueshme me burg dhe masa të tjera përfshijnë dhunën në familje, përdhunimin dhe të tjera llojet e dhunës me bazë gjinore. Gjatë përgatitjes së Strategjisë, Kodi Penal po ndryshohet në mënyrë që të jetë në pajtim me Konventën e Stambollit dhe të mbulojë inkriminimet e reja në lidhje me dhunën ndaj femrave.

Me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin e Shërbimit në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 14/20) dhe Ligjin e Mbrojtjes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 42/20), në vitin 2020, perspektiva gjinore përfshihet si pjesë e zgjidhjeve ligjore.

#### **Lidhshmëria e Strategjisë me dokumente të tjera strategjike**

SBGj-ja është një dokument strategjik kyç në politikën nacionale të barazisë gjinore. Më poshtë janë disa nga dokumentet strategjike të miratuar aktualisht që plotësojnë SRE-në në qëllimet e saj strategjike për arritjen e barazisë gjinore, si përparësi ndërsektoriale, horizontale dhe universale shoqërore dhe politike.

Barazia midis meshkujve dhe femrave zë një vend të rëndësishëm në Programin për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2020 - 2024. Në atë njihet se mënyra e vetme për të arritur prosperitet të vërtetë në shoqëri është përmes barazisë midis meshkujve dhe femrave në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Qëllimet kryesore janë rritja e numrit të femrave në pozita vendimmarrëse, çrrënjësja e stereotipave gjinore dhe eliminimi i dhunës në bazë gjinore.

#### **Dokumente strategjike të rëndësishme për barazinë gjinore:**

- Strategjia për një shoqëri dhe interkulturizëm 2020 – 2022;
- Strategjia për zhvillimin e sipërmarrjes së femrave në Republikën e Maqedonisë 2019 - 2023 me Planin e veprimit dhe Programin e reviduar për reforma në punësimin dhe politikën sociale 2022;
- Strategjia nacionale për ndërmarrje të vogla dhe të mesme 2018 – 2023, Strategjia për formalizimin e ekonomisë joformale 2018 - 2022, si dhe në Programin nacional për punë dinjitoze 2019 - 2022;

- Strategjia nacionale për bujqësinë dhe zhvillimin rural (SNBZHR) 2021- 2027 dhe Programi nacional për zhvillim të bujqësisë dhe zhvillimit rural 2018 – 2022;
- Strategjia për arsim 2018 – 2025 me Planin e veprimit i cakton drejtimet për zhvillimin e arsimit deri 2025;
- Strategjia nacionale për të rinj 2016 – 2025;
- Strategjia për përfshirje dhe komunikim me bashkësinë 2020 – 2022 dhe Strategjia nacionale dhe Plani i veprimit për kontroll të armës së vogël dhe të lehtë (AVL) 2017 – 2021;
- Plani nacional i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalim dhe luftë kundër dhunës mbi femrat dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) 2018 – 2023;
- Strategjia nacionale dhe Plani i veprimit për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal për periudhën 2021 – 2026;
- Strategjia nacionale për avancimin e shëndetit mendor 2018 – 2025;
- Plani nacional i veprimit i Republikës së Maqedonisë së Veriut për Implementimin e Rezolutës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1325 "Femra, paqe dhe siguri" 2020 – 2025, Plan afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes 2019 – 2028 dhe Plan afatmesëm për zhvillimin e mbrojtjes 2020 – 2023;
- Strategjia rregulatore për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuale 2019 - 2023;
- Strategjia nacionale (2020 – 2025) dhe Plani i veprimit (2020 – 2022) për Parandalim dhe mbrojtje të fëmijëve nga dhuna;

- Plan i veprimt për integrimin e çështjeve gjinore gjatë përgatitjes së Politikave për ndryshime klimatike në vitin 2018 në rrjedhë e përgatitja e Strategjisë për aksion klimatik;
- Strategjia nacionale për deinstitutionalizim në Republikën e Maqedonisë 2018 – 2027;
- Strategjia nacionale për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë 2009-2030;
- Strategjia nacionale për zhvillimin e kulturës është miratuar për periudhën prej 2018 - 2022.

#### **MEKANIZMA INSTITUCIONALË PËR BARAZI GJINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Republika e Maqedonisë së Veriut ka vendosur kornizë të gjerë të mekanizmave institucionale për mundësi të barabarta të femrave dhe të meshkujve në nivel qendror dhe lokal.

Komisioni për Mundësi të Barabarta të femrave dhe të meshkujve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Klubi i deputeteve janë mekanizma për zbatimin e perspektivës gjinore në organin më të lartë përfaqësues për krijimin e politikave dhe marrjen e vendimeve.

Grupi interresorial konsultues dhe këshillëdhënës për mundësi të barabarta të femrave dhe të meshkujve e promovon konceptin e përfshirjes së aspekteve gjinore në politikat e përgjithshme të të gjithë institucioneve publike.

Në nivel nacional, MPPS-ja inicion dhe krijon politika për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta, njëherësh është përgjegjëse për koordinim dhe ndjekje të gjendjes me barazinë gjinore në bashkëpunim me organet tjera të administratës shtetërore.

Në pajtim me LMBFM-në-, në të gjitha ministrinë nga radha e nëpunësve shtetërore ka koordinator të emëruar dhe zëvendëskoordinator për mundësi të barabarta të femrave dhe të meshkujve, të cilat me ligj kanë paraparë detyrime dhe përgjegjësi. Ata janë përgjegjës për vendosjen e perspektivës gjinore në ministrinë përkatëse, për zbatimin e Strategjisë.

Mekanizmat gjinore në nivel lokal në kuadër të institucioneve janë përbërë nga këto struktura: Komisione për mundësi të barabarta të femrave dhe të meshkujve dhe koordinatorë për mundësi të barabartë të femrave dhe të meshkujve.

#### **Integrimi i perspektivës gjinore**

Arritja e barazisë gjinore kërkon përfshirjen efektive të perspektivave gjinore në të gjitha prirjet, politikat dhe praktikat shoqërore. Platforma e Pekinit për veprim (1995) thotë se “Qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit gjinor në të gjitha politikat dhe programet, dhe para vendimmarrjes, do të bëhet një analizë e efekteve të tyre përkatëse të femrat dhe meshkujt”. Përfshirja e çështjeve gjinore në politikat kryesore paraqet (ri) organizim, përmirësim, zhvillim dhe evaluim i proceseve të hartimit të politikave, me perspektivën e barazisë gjinore që përfshihet në të gjitha politikat në të gjitha nivelet dhe fazat nga aktorët e përfshirë normalisht në krijimin e politikave.



Në vitin 2018, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për herë të parë prezantoi perspektivat gjinore në udhëzimet për zhvillimin e planeve strategjike trevjeçare për ministrinë resore, në mënyrë që të forcohet institucionalizimi i integritit gjinor në nivel nacional.

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), në bashkëpunim me MPPS-në, zhvilluan module për barazinë gjinore për punonjësit në administratën shtetërore. Qëllimi është që punonjësit në administratë, përmes sistemit elektronik të menaxhimit të mësimin, të fitojnë njohuri mbi perspektivën gjinore në krijimin dhe zbatimin e politikave publike.

### **Buxheti gjinor përgjegjës**

Prezantimi i konceptit gjinor në politikat buxhetore është qëllimi kryesor i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim krijimin e një buxheti të ndjeshëm gjinor, nga i cili do të kenë përfitime të barabarta edhe meshkujt edhe femrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut .

Buxhetet me përgjegjësi gjinore (BPGJ) janë çelësi për krijimin e mundësive të barabarta për femrat dhe meshkujt. Pikërisht për këtë me LMBFM-në u bë një hap drejt buxhetimit të përgjegjshëm gjinor me kërkesën, "organet e administratës shtetërore janë të detyruara në kuadër të planeve të tyre strategjike dhe buxheteve ta inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta të femrave dhe të meshkujve" (neni 11, pika 3)).

Deri në vitin 2020, buxheti i përgjegjshëm gjinor është pilotuar nga 13 ministri resoriale dhe tre agjenci shtetërore me mentorim të vazhdueshëm ekspertësh të ofruar nga UN Women. Sipas metodologjisë BPGJ, ministrinë resoriale dhe institucionet shtetërore janë të detyruara të kryejnë analizë bazë gjinore të një programi të veçantë sektorial dhe të zhvillojnë tregues të prodhimit gjinor, si dhe të vazhdojnë të monitorojë progresin në zbatimin e programeve të përzgjedhura dhe ndikimin e tyre.

### **PAQSYRË E GJENDJES ME BARAZINË GJINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Sipas vlerësimit të popullsisë së Entit Shtetëror të Statistikës (EShS) për vitin 2019, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka gjithsej 2,076,255 banorë, nga të cilët pothuajse numër i barabartë i femrave (49.92%) dhe meshkujve (50.08%). Për sa i përket strukturës së moshës, femrat në Maqedoninë e Veriut jetojnë 3,8 vjet më gjatë se meshkujt, ndërsa popullsia e përgjithshme po plaket gjithnjë e më shumë. Në periudhën nga 2007 deri në 2019, pjesëmarrja e popullatës së re femërore të moshës 0 deri në 14 vjeç është ulur nga 18,2% në 15,8%, ndërsa pjesëmarrja e popullsisë së moshuar femërore të moshës 65 vjeç e më shumë u rrit nga 12,5% në 15,8%. Një numër më i madh i femrave vërehen në grupin e moshës nga 65 vjeç e më shumë. Të dhënat tregojnë se femrat jetojnë 3,9 vite më gjatë se meshkujt, pikërisht 78,3 vite, ndërsa meshkujt 74,4 vite.

Indeksi i pabarazisë gjinore për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 është 0,143, duke e bërë Maqedoninë e Veriut në vendin e 37 -të nga 189 vende. Indeksi i zhvillimit gjinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 0,952 dhe është në grupin e dytë të vendeve me barazi mesatare deri në barazi të lartë në arritjet e Indeksit për zhvillimin e njeriut midis femrave dhe meshkujve, që është një përmirësim nga viti i kaluar, kur ishte në grupin e tretë.

Në vitin 2019, Republika e Maqedonisë së Veriut, me mbështetjen e UN Women dhe Institutin European për Barazi Gjinore, e përpunoi Indeksin e parë të Barazisë Gjinore për vitin 2015, sipas të cilit Republika e Maqedonisë së Veriut renditet në pozitën e 15 - të në krahasim me shtetet anëtare të Bashkimit European.

### **KOVID-19**

Pandemia me virusin korona SARS-COV-2, e cila shkaktoi efekte globale të pakrahasueshme me ngjarjet e tjera në shekujt 20 dhe 21, e shënoi vitin 2020 dhe fillimin e vitit 2021, periudhën e krijimit të kësaj Strategjie. Kriza që ka goditur të gjitha vendet në botë ka shkakuar pasoja të paçmueshme ekonomike dhe sociale, nga të cilat bota do të rikuperohet për një kohë të gjatë.

Për të përballuar me sukses përhapjen e infeksionit, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 18 mars 2020, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në vend. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi një sërë masash në luftën kundër Covid-19, duke arritur të ruajë një situatë të qëndrueshme në vend dhe duke ofruar mbështetje për kategoritë e cenueshme të qytetarëve.

Më 10 Mars 2020 Qeveria miratoi masë që ndërpreu procesin arsimor dhe mësimin në të gjitha kopshtet dhe shkollat fillore. Në të njëjtën kohë, u mor vendim për lirim të një prej prindërve, fëmijët e të cilit ndjekin kopshtin ose shkollën fillore deri në moshën dhjetëvjeçare, nga përgjegjësitë e punës. Qeveria ka këshilluar punëdhënësit në vend, në varësi të llojit të punës dhe mundësive, të rregullojnë punën që duhet bërë nga shtëpia.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi pesë pako masash, që kanë për qëllim përballimin e pasojave negative në ekonomi.

Gjatë periudhës së izolimit dhe vendosjes së orës policore të rreptë, MPPS-ja dhe organizatat joqeveritare paralajmëruan për rrezikun e rritjes së rasteve të dhunës në familje. Gjatë orës policore, femrat viktimat të dhunës u lejuan të kërkojnë ndihmë dhe të raportojnë dhunën në familje, dhe gjatë gjithë periudhës u ndanë kontakte nga serviset për paraqitje dhe mbështetje të viktimave.

### **ANALIZË E GJENDJES SIPAS SFERAVE SPECIFIKE**

#### **1. Ekonomia dhe tregu u punës**

Sipas Entit Shtetëror të Statistikës (ESHS), në vitin 2019 nga gjithsej 964 014 popullsi aktive, meshkujt janë 571 635 dhe femrat 392 379. Shkalla e aktivitetit për meshkujt është 67,8% dhe për femrat 46,6%. Në tremujorin e tretë të vitit 2020 shkalla e punësimit për meshkujt e moshës 15 deri në 64 vjeç ishte 62,7% dhe për femrat 45,2%, që është një rritje prej 0,6% në tremujorin e tretë të vitit 2019. Shkalla e aktivitetit në tremujorin e tretë të vitit 2020 për meshkujt e moshës 15 deri në 64 vjeç ishte 75,7% dhe për femrat 53,9%.

Sipas statusit të punësimit, femrat mbizotërojnë në kategorinë "punëtor i papaguar i familjes" me përfaqësim pothuajse të dyfishtë në krahasim me meshkujt (61,8% kundrejt 38,2%), ndërsa meshkujt janë më shumë punëdhënës (në 2019, 73,3% kundrejt 26,7%) dhe tre herë më shumë punonjës për llogari të vet (78% kundrejt 22%).

Femrat janë më të përfaqësuara në punë me pagë më të ulët, kështu që në vitin 2019, 7,2% e meshkujve dhe 5,2% e femrave morën pagë prej 25.000 deri në 30.000 denarësh, ndërsa 77,6% e atyre që fitonin mbi 40.000 denarë ishin meshkuj dhe 22,4% ishin femra. Përveç kësaj, ekziston një hendek gjinor në pagat prej 12%, që do të thotë se për një vend pune të njëjtën vlerë, femrat marrin një pagë 12% pagë më të ulët se meshkujt. Hendeku gjinor në pensionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 është 23,8% për moshën mbi 65 vjeç, ndërsa për moshën 65 deri në 74 vjeç është 18,7%. Ekziston ndarje e rëndësishme sektoriale, pra një përqendrim i lartë i punësimit të femrave kundrejt meshkujve në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale, të njohur si sektorë që identifikohen me "kujdes" dhe paguhen më pak.

Ministria e Ekonomisë realizon mbështetje financiare për femrat sipërmarrëse, subvencionon ndërmarrjet që janë në pronësi të femrave dhe të cilat drejtohen nga femra. Në vitin 2020 me këtë masë janë mbështetur 11 aplikantë me 1.068.206,00 denarë.

Agjencia e Mbështetjes së Sipërmarrësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Programin për mbështetjen e sipërmarrësisë, konkurrencës dhe inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2020 (botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 18, 27 janar 2020) dhe Programi për ndryshimin e Programit për mbështetjen e sipërmarrësisë, konkurrencës dhe inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2020, parashikoi 11 masa dhe aktivitete programore. Me Programin për vitin 2020, u realizua mbështetje financiare për grupet e synuara të femrave të papunësuar dhe në shumë prej 1.970.000,00 denarë përmes aktiviteteve të programit: Mbështetje për vetëpunësim (sipërmarrje), sistem me vauçerë për këshillim, Shërbime të standardizuara mentorimi dhe Mbështetje për sipërmarrjen e femrave përmes trajnimeve në mënyrë që të informohen femrat në lidhje me instrumentet për mbështetjen financiare të sipërmarrësisë së femrave.

Në vitin 2020 Në programet dhe Masat aktive të punësimit të zbatuara nga Agjencia e Punësimit, pjesëmarrja e femrave është rreth 34% e personave të përfshirë në programin "mbështetje për vetëpunësim" (sipërmarrje) dhe rreth 48% e personave të përfshirë në masat për "mbështetje për krijimin e vendeve të punës", në masën subvencionim i rrogave 49%, punësimin dhe rritjen e subjekteve juridike 48%, dhe mbështetjen për punësimin e personave me aftësi të kufizuara 30%.

Në vitin 2019, Ministria e Bujqësisë, Pyltarsisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) për herë të parë krijoi dhe shpalli një masë për të mbështetur një anëtare aktive femër në fermën bujqësore të familjes për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore në shumën maksimale prej 180.000,00 denarë për ekonomi bujqësore, me ç'rast në thirrje janë paraqitur 400 femra nga zonat rurale.

Për të përmirësuar ekuilibrin midis përgjegjësisë shtëpiake dhe punës së femrave, për pjesëmarrjen më të madhe të tyre në tregun e punës, zgjerohen kapacitetet nacionale për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve parashkollorë dhe është propozuar orari i punës i kopshteve për të mbështetur prindërit që punojnë deri më vonë dhe në fundjavë.

Në vitin 2020 MPPS-ja i rriti kapacitetet e institucioneve për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollorë për shkak të përfshirjes së një numri më të madh të fëmijëve në arsimin parashkollor, nga marsi 2020 përfundimisht në shkurt 2021, u hapën gjithsej 12 objekte të kopshteve dhe 2 objekte të kopshteve private. Për këtë qëllim sipas buxhetit dhe

Programit për ndërtimin, pajisjen dhe mirëmbajtjen e objekteve për mbrojtjen e fëmijëve në vitin 2020 janë realizuar fonde në vlerë prej 82.569.000,00 denarësh, që është 99,7% e planifikuar në Planin Vjetor.

## 2. Bujqësia

Republika e Maqedonisë së Veriut është vend kryesisht bujqësor, në të cilin zonat rurale mbulojnë rreth 87% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, ku jeton 45% e popullsisë së përgjithshme.

Në zonat rurale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, femrat bartëse të ekonomive në kuadër të numrit të përgjithshëm të bujqve janë rreth 10,4%, dhe vetëm 12,01% e femrave janë pronare të tokës me pjesëmarrje të ulët në procesin e vendimmarrjes të rëndësishme për aktivitetet prodhuese.

MBPEU në ndryshimet e fundit në Ligjin e Konsolidimit të Tokës Bujqësore futi dispozitë për Deklarata të detyrueshme të pëlqimit të bashkëshortit për planin për shpërndarjen e tokës bujqësore, dhe duke pasur parasysh se shumica e pronarëve janë meshkuj, kjo do të thotë konsultim i detyrueshëm i femrave në procesin.

Për të siguruar barazinë gjinore dhe për të përmirësuar pozitën e femrave të angazhuara në bujqësi, Strategjia Nacionale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2021 - 2027 siguron mbështetje për aktivitetin ekonomik të femrave fermerë me pagesa shtesë direkte, me grant për aktivitetet e përpunimit të bujqësisë dhe përfitimet në renditjen e projekteve nga programi i ri IPARD me 20 pikë shtesë në masën 1 dhe 10 pikë në masat 3 dhe 7.

## 3. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe ballafaqimi me ndryshimet klimatike

Efektet negative të ndryshimit të klimës, si dhe vetë ndryshimet klimatike, përbëjnë një kërcënim global që duhet të adresohet me një qasje sistematike dhe të përgjegjshme gjinore.

Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë për vitin 2020 të Qeverisë, mori parasysh grupet e cenueshme, ndër të cilat 4 femra morën subvencione. Programi për promovimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë dhe inkurajimin e efikasitetit të energjisë në familje nga viti 2021 mori parasysh disa lloje të grupeve të cenueshme, me çka do të pritet pjesëmarrje më të madhe të femrave në këto programe.

Aspekti gjinor i ndryshimit të klimës në vendin tonë është analizuar në mënyrë aktive në kuadër të projektit rajonal të mbështetur nga Programi Mbështetës Global dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH), në bashkëpunim me UNDP -në, ka filluar të përfshijë një perspektivë gjinore në dokumentet e ndryshimit të klimës me Raportin e parë dyvjeçar të ndryshimeve klimatike të dorëzuar në Konventën e OKB -së për ndryshimet klimatike. Miratimi i Raportit të tretë dyvjeçar të ndryshimeve klimatike është në proces, si dhe përgatitja e Planit të katërt nacional të ndryshimit të klimës, në të cilin aspekti gjinor është një kriter i fortë për zbatimin efektiv të ndryshimit të klimës. Në vitin 2019 ishte përpunuar Draft-Plani nacional i veprimit për përfshirjen e aspektit gjinor në ndryshimet klimatike.

#### 4. Politika dhe miratim i vendimeve

Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare në vitin 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka 48 deputete (39,17%), i cili e rendit Maqedoninë e Veriut në vendin e 31-të në listën globale të Lidhjes Interparlamentare (IPU). Femrat kryesojnë shtatë nga 21 komisionet parlamentare.

Në përbërjen e fundit të Kuvendit për herë të parë ka një deputete rome.



Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të balancimit gjinor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni për Mundësi të Barabarta të femrave dhe të meshkujve miratoi një Plan të aktiviteteve për avancimin e ndjeshmërisë gjinore të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020-2021.

Në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga gjithsej 20 anëtarë dhe 16 ministri, ka 4 femra në pozita ministore (20%), përkatësisht Ministria e Kulturës, MPPS-ja, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Mbrojtjes. Në 2 ministri, edhe atë ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, femrat janë zëvendësministre. Nga 37 persona në pushtetin ekzekutiv në vitin 2021, 6 janë femra, përkatësisht 16,2%.

Në zgjedhjet lokale në vitin 2017 kandiduan 15 femra nga gjithsej 260 kandidatë për kryetarë komune, nga të cilët gjashtë u zgjedhën kryetare të komunave (7,4%), që është ende numri më i lartë në të gjitha zgjedhjet lokale të deritanishme. Nga 1.388 këshilltarë lokal, 415 janë femra (29,8%), dhe 18,5% e këshillave komunal kryesohen nga femrat. Në 15 nga komunat ata kanë 40% dhe më shumë përfaqësim të femrave, dhe 31 komuna kanë më pak se 30% përfaqësim të këshilltareve.

Sipas Regjistrir të të punësuarve në sektorin publik (2019), 55% e të punësuarve janë femra dhe 45% janë meshkuj, për sa i përket pozicioneve udhëheqëse në sektorin publik rreth 36% janë femra. Femrat janë më të përfaqësuara në institucionet gjyqësore, ndërsa meshkujt më shumë në sektorin e sigurisë. Pabarazia më e madhe gjinore vërehet në ndërmarrjet publike, ku meshkujt janë 83.36% të të punësuarve dhe femra 16.64%. Në vitin 2019 nga gjithsej 23,266 anëtarë të organeve legjislativë dhe ekzekutive, funksionarë shtetërorë, nëpunës shtetëror udhëheqës, diplomatë dhe drejtorë, vetëm 6,111 ishin femra.

## 5. Shëndetësia

Shkalla e fertilitetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 ishte 1,3 fëmijë të lindur të gjallë për një grua, që është nën mesataren e BE -së (1,6), dhe shkalla e vdekshmërisë së foshnjave është 5,6 foshnje të vdekura në 1000 fëmijë të lindur të gjallë.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) me Programin për kujdesin shëndetësor aktiv të nënave dhe fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nivel vjetor, zbaton masa për të zvogëluar morbiditetin dhe vdekshmërinë e nënave dhe të porsalindurve përmes një qasje të integruar në promovimin e shëndetit të nënave dhe të sapolindurve.

MSH siguron ekzaminime dhe ekzaminime laboratorike falas gjatë shtatzënisë, lidhur me shtatzëninë, lindje falas të femrave shtatzëna që janë jashtë sistemit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe personave pa dokument identifikimi.

MSH zbaton Program për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje i cili miratohet në nivel vjetor dhe në vitin 2020 përmban: skringing për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës; skringing pilot për kancerin kolorektal; fushatë promovuese për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të prostatës; dhe skringing mamofemrafik të organizuar për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

## 6. Arsimi dhe shkenca

Në shkollat fillore (gjithsej 1042), në vitin akademik 2019/2020 u regjistruan më shumë nxënës (96 740 nxënës kundrejt 90 500 nxënës), ndërsa ka dukshëm më shumë mësimdhënësë se mësimdhënës (12 862 mësimdhënësë kundrejt 5359 mësimdhënës). Në shkollat e mesme (gjithsej 138) situata është e ngjashme, përkatësisht në vitin shkollor 2019/2020, janë regjistruar 36 297 nxënës dhe 33 683 nxënës dhe ka 4 493 mësimdhënësë dhe 2 852 mësimdhënës.

Në arsimin e lartë, situata është e kundërt - në vitin 2019 kishte më shumë femra sesa meshkuj të regjistruar dhe diplomuar (58,85% femra të diplomuara dhe 41,15% meshkuj), nga gjithsej 204 doktor të shkencave 122 ishin femra, ndërsa numri i profesoreve ordinare dhe inordinare (552 dhe 406, respektivisht). Përveç kësaj, 40% e femrave marrin pjesë në arsim dhe trajnim formal ose jo-formal, krahasuar me 23% të meshkujve. Në Akademinë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve, nga 38 anëtarë (të rregullt dhe korrespondent) vetëm 4 janë femra, femër nuk ka qenë kurrë kryetare, nënkryetare apo sekretare.



Burimi :ESHs

Si një nga masat e zbatuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH) në lidhje me këtë çështje, në vitin shkollor 2019/2020 u dhanë më shumë bursa për studentet femra (63,7%) sesa për studentët (36,3%) për shkenca bioteknike, teknike-teknologjike, natyrore-matematikore, IT, kimi, fizikë, matematikë dhe shkenca mjekësore.

Grupi punues multisektorial i ekspertëve, propozoi model për zbatimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGJ) si pjesë e arsimit fillor formal. Programi do të fillojë me pilotim në vitin shkollor 2021/2022, në 4 shkolla në zonat urbane dhe rurale.

## 7. Femra, paqe dhe siguri

Sipas Indeksit për femrat, paqen dhe sigurinë 2019/2020, Republika e Maqedonisë së Veriut gjendet në vendin e 37 -të nga 167 vende, e matur me tregues për tre dimensione bazë: gjithëpërfshirjen, drejtësinë dhe sigurinë. Ministria e Mbrojtjes (MM), duke zhvilluar vazhdimisht trajnime gjinore për kategori të ndryshme personeli, për të cilat ka 18 trajnerë të certifikuar gjinorë, duke mbajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë për të gjitha kategoritë e personelit dhe personelit të trajnuar në vend dhe jashtë vendit, si dhe vendosjen e mekanizmave të brendshëm për parandalimin dhe veprimin në rast të shqetësimit. Janë emëruar këshilltari gjinor (oficer për barazi gjinore në Armatën) dhe përfaqësues gjinorë që tani janë të pranishëm në pothuajse të gjitha strukturat e Armatës. Në vitin 2020 pjesëmarrja e femrave në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ishte 9,91%, përkatësisht 15,55% oficerë femra, 11,18% femra nënoficerë, 5,45% ushtarë profesionistë dhe 37,47% femra civile në shërbim të Armatës.

Në 2019 numri i femrave me gradën kolonel është rritur për 3 herë, ndërsa në vitin 2018 për herë të parë një kolonele femër është emëruar si axhutante e Presidentit të shtetit.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në Planin e saj Strategjik 2020 - 2022, e përfshin çështjen e barazisë gjinore, përkatësisht monitorimin e përfaqësimit gjinor dhe të barabartë, në programin "Avancimi i funksioneve të përbashkëta në MPB", nënprogrami "Menaxhimi me Resurse Njerëzore"

## 8. Siguria sociale

Përfshirja e perspektivave gjinore në politikat sociale nuk është vetëm çështje e drejtësisë sociale, por edhe një çështje e rëndësishme në ballafaqimin me varfërinë, sigurimin e mundësive të barabarta dhe një cilësi të mirë të jetës për të gjithë. Sistemi efektiv i mbrojtjes sociale merr parasysh nevojat e ndryshme, përparësitë dhe aspiratat e ndryshme të meshkujve dhe femrave në luftën kundër pabarazive sociale, si dhe dallimet midis vetë femrave, përmes parimit të interseksionalitetit.

Një reformë e rëndësishme e ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në këtë fushë është reforma e sistemit social. Vitet e fundit, fokusi i sistemit të mbrojtjes sociale ka qenë mbi shërbimet sociale për grupet e cënueshme, si në shtëpi ashtu edhe në bashkësi.

Reforma në vitin 2019, e cila filloi me miratimin e Ligjit të Mbrojtjes Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/19), Ligji i Sigurisë Sociale për të moshuarit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/2019) dhe ndryshimi i Ligjit të Mbrojtjes së fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/2019.), i drejtoi dhe zgjeroi programet e ndihmës sociale.

Në korrik të vitit 2020 Republika e Maqedonisë së Veriut u zgjodh anëtare e Komisionit për Zhvillim Social të OKB-së për periudhën 2020 - 2024.

## 9. Qasja në drejtësi

Ligji i Ndhmës Juridike Falas ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/19) garanton ndihmë juridike të shkallës së parë dhe të dytë për qytetarët që nuk kanë mjete të mjaftueshme.

Qytetarët mund të marrin ndihmë juridike falas për konteste pronësore-juridike, marrëdhëniet kreditore-debitore, për çështjet e sigurimit pensional dhe invalidor, për përfaqësimin e viktimave të dhunës në familje, për realizimin e ndihmës sociale, për konteste me kompanitë e sigurimeve, por edhe për nevoja të tjera. Ndihma juridike falas jepet në të gjitha gjykatat dhe procedurat administrative. Femrat viktime të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje janë përfshirë në këtë ligj.

Në vitin 2020 u miratua Ligji i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe u zgjodh Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, me çka përfordhet sistemi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

## 10. Sporti

Sipas Indeksit të barazisë gjinore për vitin 2015, numri i femrave në pozita drejtuese në federatat nacionale të sportit është më i ulët nga të gjitha sferat e tjera shoqërore. Në nënfushën "Fuqia Shoqërore" hendeku më i madh gjinor është në treguesin që e mat pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në organet drejtuese dhe trupat e federatave nacionale të sportit, përkatësisht në Maqedoninë e Veriut vetëm 8,9% femra kundrejt 91,1% meshkuj janë anëtarë të organeve drejtuese në to.



Agjencia për të Rinj dhe Sport (ARS) jep bursa për rezultate të arritura sportive në sportet olimpike dhe paraolimpike, përkatësisht jo-olimpike dhe jo-paraolimpike, për sportistët e rinj të talentuar deri në moshën 20 vjeçare (projekti "500 bursa për sportistët e rinj të talentuar"). Çdo vit numri i vazave të përfshira në këtë projekt po rritet.

Në vitin 2020 u regjistruan 4 klube të futbollit të femrave, ndërsa në vitin garues 2020-2021 në Federatën e Futbollit të Maqedonisë janë regjistruar gjithsej 1505 vajza që merren me lojën e futbollit. Gjithashtu, pas një mungese të gjatë të një ekipi nacional të volejbollit për femra, Federata e Volejbollit të Maqedonisë, përmes disa shkollave të volejbollit dhe një ekipi profesional të trajnerëve meshkuj dhe femra, formon një ekip nacional në garat e të rinjve deri në moshën 19 vjeçe.

## 11. Kultura

Sipas të dhënave të Ministrisë së Kulturës (MK) në vitin 2021, nga buxheti i ministrisë financohen 65 institucione nacionale në fushën e kulturës, në të cilat janë të punësuar 2955 persona, nga të cilët 48% femra dhe 52% meshkuj.

Në buxhetin e RM-së për vitin 2019, aspekti gjinor përfshihet, ndër të tjera, në kategorinë "Projektet ndërdisiplinore", ku financohen projekte nga sektori i pavarur kulturor, jashtë institucioneve kulturore, brenda të cilave u mbështetën 105 projekte, nga të cilat 9 projekte të femrave bartëse si persona fizikë dhe 8 si persona juridikë.

Në programin e RM-së për vitin 2020, nga 856 botime të financuara, 250 janë nga autorët, që është rreth 30% e numrit të përgjithshëm të librave / botimeve të mbështetura. Për sa i përket botimeve elektronike, nga 28 të mbështetura, 8 u veçuan si projekte të drejtuara nga femrat ose që trajtojnë çështje gjinore.

## 12. Mediet

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fund të vitit 2019 ishin aktivë gjithsej 120 radiodifuzerë, pra 48 televizione dhe 72 radio stacione. Sipas të dhënave të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA), femrat në industrinë e mediave audiovizuale rrallë shfaqen si pronare. Në 2019 nga gjithsej 48 stacione televizive, 3 ishin në pronësi të drejtpërdrejtë të femrave, 28 në pronësi të drejtpërdrejtë të meshkujve, dhe një situatë e tillë nuk ishte e ndryshme në 2018 dhe 2017. Nga 72 radio stacione, 43 ishin 100% në pronësi të meshkujve dhe 22 në pronësi të femrave. Femrat dominojnë në profesionin e gazetarisë, me 540 gazetarë dhe 374 gazetarë në mediat tona në 2018.

Sipas hulumtimit të ASHMAA, në mediat tona as temat që lidhen me çështjet gjinore nuk përpunohen nga perspektiva gjinore. Shtojcat që kanë të bëjnë në sferën private, zakonet, shtëpia dhe familja nuk përpunohen përmes prizmit të gjinisë, as që hapen çështjet për rolet gjinore në shoqëri, por femrat tradicionalisht identifikohen me shtëpinë dhe familjen.

### 13. Dhunë mbi baza gjinore

Dhuna ndaj femrave konsiderohet një fenomen mjaft i përhapur në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Tri nga pesë (60%) femra konsideronin se dhuna kundër femrave është e zakonshme dhe pothuajse tre nga dhjetë konsideronin se ishte një dukuri shumë e shpeshtë. Pothuajse një nga pesë femra (17%) njej dikë në familjen e tyre dhe në mesin e miqve të tyre që kanë përjetuar një formë të dhunës në familje, dhe përqindja e njerëzve në lagjen e tyre që kanë përjetuar dhunë është e ngjashme.

Qeveria në 2018 tregoi vullnet të fortë politik për të eliminuar të gjitha format e dhunës ndaj femrave me ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Femrave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe përgatitjen dhe miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Konventës 2018-2023.

Në përputhje me udhëzimet e Planit Aksional për zbatimin e Konventës së Stambollit, u miratua një Ligj i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj femrave dhe dhunës në familje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Numër 24/2021), e cila do të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse të integruar multidisiplinare në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me standardet ndërnacionale.

Në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2020 funksionojnë 13 shërbime të specializuara për përkujdesjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

MPPS së bashku me UNDP-në krijojnë aplikacionin e parë celular për ndihmë dhe mbështetje ndaj viktimave të dhunës "Qëndro e sigurt", e disponueshme në gjuhën maqedonase, shqipe dhe rome.

#### 13.1 Stereotipa dhe seksizëm

Seksizmi dhe sjellja seksiste janë të lidhura me dhunën ndaj femrave dhe vajzave, me çka veprat e seksizmit "të përditshëm" janë pjesë e një vazhdimësie të dhunës duke krijuar një atmosferë frikësimi, frike, diskriminimi, përjashtimi dhe pasigurie, duke kufizuar mundësitë dhe lirinë e femrave dhe vajzave. Stereotipat gjinore dhe paragjykimet formojnë normat, sjelljen dhe pritshmëritë e meshkujve dhe djemve, që çon në aktet seksiste.

#### 13.2 Tregtia me njerëz

Viktimat e tregtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë së Veriut rrjedhin nga vendi dhe jashtë vendit, kryesisht nga Europa Lindore, dhe janë kryesisht femra dhe vajza që shfrytëzohen për punë seksuale dhe punë në restorante, bare dhe klube nate. Abuzimi i fëmijëve përmes shfrytëzimit të detyruar seksual dhe martesave të detyruara dhe lypjes mbeten format mbizotëruese të trafikimit të qenieve njerëzore. Migrantët që kalojnë nëpër vend janë gjithashtu një kategori e prekshme, veçanërisht femrat dhe të miturit e pashoqëruar. Për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore në gjendje krize u zbatuan Standarde Multisektoriale Operative të Veprimit (SMOV) si pjesë e Planit të Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Krizë / gjendje urgjente dhe Procedurat Standarde Operative (PSO) për të punuar me të mitur të pashoqëruar.

Në drejtim të identifikimit proaktiv, Funkcionon Njësia Nacionale për Luftimin e Kontrabandës së Migrantëve dhe Trafikimit të Njerëzve (NJKLKMTNJ) dhe janë formuar pesë ekipe mobile të përbëra nga punonjës socialë, nëpunës policie dhe anëtarë të sektorit civil.

Mekanizmi Nacional për menaxhim me viktimat e tregtisë me njerëz në suaza të MPPS -së punon për parandalimin dhe koordinimin e mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz.

Qeveria është plotësisht e përkushtuar në zbatimin e Marrëveshjes Globale OKB për migrim të sigurt, të rregullt. Janë nënshkruar protokolle dhe marrëveshje për luftimin e tregtisë me njerëz me vendet fqinje, me çka forcohet bashkëpunimi rajonal për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e viktimave të trafikimit në drejtim të të drejtave të tyre themelore të njeriut.

Gjatë përgatitjes së kësaj Strategjie, në rrjedhë është përgatitja e Ligjit të Kompensimit të Viktimave të Veprave Penale.

#### **KORNIZA STRATEGJIKE E STRATEGJISË**

Vizioni i Strategjisë është avancimi i barazisë gjinore në shoqëri në të cilën femrat dhe meshkujt, vajzat dhe djemtë, kanë të drejta të barabarta, qasje në resurse, mundësi dhe mbrojtje në të gjitha sferat e jetës, si kusht për zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, ekonomik, demografik, zhvillim social dhe përparimi i vendit, respektivisht shoqëri në të cilën femrat dhe meshkujt do të kenë të njëjtat privilegje dhe përgjegjësi, të cilat do t'i arrijnë në një partneritet të vërtetë të përbashkët.

#### **PRIORITETE TË IDENTIFIKUARA SIPAS SFERAVE**

##### **Mekanizma institucionalë për barazi gjinore**

Për funksionim më të mirë për avancimin e barazisë gjinore dhe pozitën e femrave në vend, është e nevojshme të krijohet një organ i veçantë brenda degës ekzekutive, i cili do të ketë përgjegjësi dhe kompetenca të caktuara specifike për zonën dhe i cili do të koordinojë mekanizmat gjinorë në të gjitha nivelet. Gjithashtu nevojitet sistematizim i vendit të punës koordinator/re për mundësi të barabarta, me çka që do të avancohen kompetencat e pozitës në institucione, në vetëqeverisjen lokale dhe në struktura të tjera. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme të përcaktohen qartë përgjegjësitë e komisioneve dhe koordinatorëve për mundësi të barabarta në dokumentet kryesore të komunave.

E rëndësishme për integrimin e perspektivës gjinore është monitorimi i situatës përmes të dhënave të përditësuara dhe indikatorëve të vendosur relevant. Nevojitet vendosja e sistemit të grumbullimit të të dhënave dhe matjes së situatës përmes indikatorit. Mbledhja e të dhënave duhet të përshtatet me indikatorët për përcjelljen e implementimit të Strategjisë dhe Planit Aksionar Nacional që duhet të pasqyrohet në raportet e paraqitura nga organet e administratës shtetërore (OASH) dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL).

##### **Ekonomia dhe tregu i punës**

Prioriteti kryesor në fushën e ekonomisë është aktivizimi i popullsisë femërore dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës. Ky prioritet është gjithashtu i lartë në strategjitë e tjera në nivel nacional, të cilat i referohen avancimit të ekonomisë dhe rritjes së punësimit. Rritja e aktivizimit dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës lidhen me cilësinë e punës së femrave, në aspektin e punësimit formal dhe punës me orar të plotë pune, si dhe masat e përcaktuara dhe shërbimet mbështetëse për harmonizimin e jetës private dhe profesionale të femrave, ku përfshijnë oraret fleksibile të punës, pushimin prindëror për meshkujt, cilësinë e kontratave të punës dhe të ngjashme. Gjithashtu nevojitet zvogëlimi i hendekut gjinor në paga, i cili së

bashku me shkallën e ulët të punësimit dhe pjesëmarrjen në ekonominë joformale, kontribuojnë në hendekun gjinor të pagave, i cili ndikon ndjeshëm në cilësinë e jetës së femrave pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

### **Bujqësia**

Në zonat rurale, femrat duhet të përforcohen sa i përket pronës bujqësore dhe menaxhimit të tokës, si dhe të ndërtojnë vetëbesimin e tyre dhe kapacitetin vendimmarrës. Fuqizimi i femrave nga mjediset rurale duhet të synojë gjithashtu në ndërtimin e kapaciteteve dhe njohurive të tyre për të aplikuar për programe mbështetëse financiare në bujqësi, por edhe në programe të tjera siç është Ministria e Ekonomisë përmes programeve për zhvillimin e sipërmarrësisë së femrave ku ofrojnë mundësi për fillimin e biznesit dhe vetëpunësim, që, në të njëjtën kohë, nënkupton diversifikimin e aktiviteteve në zonat rurale dhe kontributin në qëndrueshmërinë e tyre duke hapur biznese të vogla që nuk janë të lidhura kryesisht me bujqësinë, të tilla si parukeri lokale, dyqane për përpunimin dhe shitjen e prodhimeve të përpunuara tradicionale, zhvillimin e turizmi rural, etj.

Nevojiten masa për përfshirjen e femrave nga ekonomia joformale në atë formale, respektivisht formalizimin e punës që bëjnë. Është e nevojshme të miratohen masa për rritjen e numrit të fermerëve të regjistruara dhe të pronareve të ekonomive bujqësore nëpërmjet vlerësimit të duhur të punës së tyre. Gjithashtu nevojiten ndryshime legjislative për të njohur të drejtat e tyre për benefite sociale, duke përfshirë pushimin mjekësor, pushimin prindëror dhe pensionet. Për këtë do të kontribuojë hapja e më shumë shërbimeve për fëmijët dhe të moshuarit në mjediset rurale, vendosja e masave për të vlerësuar punën e kujdesit dhe të ngjashme.

### **Ndryshimet klimatike**

Prioriteti kryesor në fushën e ndryshimit të klimës është përfshirja e një perspektive gjinore në politikat, masat dhe strategjitë e miratuara në nivel nacional dhe lokal. Për këtë qëllim, nevojitet pjesëmarrje më e madhe e femrave në strukturat vendimmarrëse, pjesëmarrja e ekspertëve gjinorë, të cilët do të vënë në dukje ndikimet e ndryshme të ndryshimeve klimatike tek femrat, veçanërisht femrat nga kategoritë e cenueshme, me çka do të vendosen masa për ndërhyrje të hershme dhe për zvogëlimin e rreziqeve që do të drejtohen ndaj tyre. Veçanërisht është e rëndësishme të merren parasysh dallimet në nevojat dhe kërkesat e femrave dhe meshkujve në bujqësi, energji, resurset ujore, telekomunikacion, transport, menaxhim të zonave të mbrojtura dhe turizëm. Gjithashtu, e rëndësishme të forcohet kapaciteti i politikëbërësve dhe masat për të zbutur efektet e ndryshimit të klimës për të përfshirë një perspektivë gjinore.

### **Politika dhe miratimi i vendimeve**

Nevojitet të rritet numri i femrave në pozita vendimmarrëse në pushtetin ekzekutiv, partitë politike, mediat, sportet, vetëqeverisjen vendore, pra në të gjitha fushat ku nuk janë vendosur zgjidhje ligjore ose kuota dhe ku pjesëmarrja e femrave është shumë të ulët, sipas Angazhimit 50-50. Rritja e numrit të femrave vendimmarrëse duhet të bëhet përmes masave nxitëse, sensibilizimit, ndërgjegjësimit, si dhe me masa të detyrueshme ligjore. Veçanërisht e rëndësishme është inkurajimi i femrave që të marrin pjesë në strukturat vendimmarrëse në njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku merren vendime dhe masa që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

### **Shëndetësia**

Fokusi i kujdesit shëndetësor janë femrat nga komunitetet e marginalizuara në mënyrë që të përmirësohet qasja e shërbimeve nga sistemi i kujdesit shëndetësor. Nevojitet të rritet numri i ambulancave gjinekologjike dhe gjinekologëve jashtë Shkupit, në vendet ku jetojnë komunitetet e marginalizuara, për të zvogëluar vdekshmërinë e foshnjave dhe të fëmijëve nën moshën 5 vjeçe. Ekziston gjithashtu një nevojë për rregullim më të mirë dhe rritje e përfshirjes së femrave me Programin për Zbulimin e Hershëm të Sëmundjeve Malinje (skrining për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës; skrining i kancerit kolorektal; skrining mamografik për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit).

Nevojitet vendosja e masave për të avancuar shëndetin seksual dhe riprodhues të femrave, me fokus tek femrat nga kategoritë e cenueshme, duke siguruar mbështetje të plotë për femrat pas periudhës riprodhuese, menopauzës dhe mbështetje për femrat që nuk janë në një komunitet heteroseksual ose thjeshtë në çfarë do komuniteti, për të realizimin e dëshirës për amësi përmes fekondimit të asistuar biomjekësor (FAB).

Për më tepër, kriza me pandeminë Covid-19 ka sjellë në plan të parë shëndetin mendor, të cilit duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë te femrat që gjatë pandemisë u përballën me barrë shtesë në shtëpi, duke u kujdesur për fëmijët dhe të moshuarit.

### **Arsimi dhe shkenca**

Arsimi i plotë i barabartë, sensitiv dhe i rregullt gjinor do të arrihet duke mbajtur vajzat nga grupet e cenueshme në procesin arsimor, duke inkurajuar vajzat të arsimohen në fusha që konsiderohen "mashkullore", dhe të cilat si profesione paguhen më shumë dhe ofrojnë zgjedhje më të madhe të vendeve të punës. respektivisht janë profesionet e së ardhmes, si dhe sigurimi i kushteve për femrat që të përparojnë në arsimin e lartë dhe shkencën përmes masave të veçanta për stimulim dhe mbështetje.

Krijimi i programit pilot të VSE-së ishte një hap i rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore dhe edukimin e të rinjve për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe marrëdhëniet e shëndetshme. Programi duhet të vendoset në të gjitha shkollat në vend që të përfshijë edhe kategoritë më të cenueshme.

Së fundi, aspekti gjinor i infrastrukturës shkollore duhet të merret parasysh, pra nevojat e vajzave për menaxhimin e higjienës menstruale.

### **Femra, paqe dhe siguri**

Koncepti i paqes pozitive përfshin jo vetëm mungesën e luftës si kusht për paqen, por edhe tejkalimin e dhunës dhe pabarazisë kulturore dhe strukturore për të arritur mirëqenie të plotë dhe përparim, përmes mundësive të barabarta dhe qasjes në servise, shërbime dhe masa mbështetëse të ndërtuara me investime të qëndrueshme në zhvillimin ekonomik dhe institucionet, si dhe ndërtimin e një kulture të barazisë dhe mosdiskriminimit. Për një shoqëri që ndërton një kulturë të paqes pozitive, nevojitet pjesëmarrje e barabartë e femrave në strukturat e mbrojtjes, sigurisë dhe marrëdhënieve ndërnacionale. Prioritet i rëndësishëm në këtë kuptim, i cili lind edhe me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, është rritja e numrit të femrave në Armatë dhe në misionet paqeruajtëse, rritja e numrit të femrave në polici, duke ndërtuar në thelb një kulturë të barazisë gjinore në këto institucione dhe struktura.

Gjithashtu, aspekt tjetër i rëndësishëm është sensibilizimi i punonjësve në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë, veçanërisht punonjësit e policisë, në lidhje me çështjet gjinore dhe sjelljet e ndjeshme ndaj gjinisë.

### **Mbrojtja sociale**

Mbrojtja sociale është veçanërisht e rëndësishme që të synojë kategoritë e prekshme të femrave dhe të marrë parasysh ndërthurjen e karakteristikave të tyre në krijimin dhe miratimin e masave të ndihmës dhe mbështetjes. Gjithashtu, nevojitet rritje e kapaciteteve të punonjësve socialë për çështjet gjinore, si dhe për të përmirësuar mbulimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore, veçanërisht në zonat rurale.

Lidhur me krizën me pandeminë Kovid-19, në krijimin e masave duhet të përfshihet qasje ndër sektoriale në mënyrë që të arrihet efektiviteti dhe mbulimi i lartë i femrave nga kategoritë e cenueshme, gjë që do të zvogëlojë pasojat e krizës.

### **Qasja në drejtësi**

Nevojitet qasje e plotë dhe efektive në drejtësi për grupet e cenueshme të popullatës, përfshirë femrat viktime të dhunës. Gjithashtu nevojitet avancimi i vetëdijes dhe sensibilizimi i praktikuesve ligjorë në lidhje me çështjet e barazisë gjinore për shkak të mundësisë së rigjallërimit dhe diskriminimit të personave nga kategoritë e cenueshme me të cilët ata vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë.

Fusha e drejtësisë përfshin gjithashtu edhe të burgosurat që kanë nevojë të përmirësojnë qasjen në shërbimet shëndetësore, arsim dhe programet profesionale, të cilat do të lehtësojnë riintegrimin e tyre në shoqëri.

### **Sporti**

Prioriteti kryesor në fushën e sportit është rritja e numrit të femrave në pozicione drejtuese në struktura të ndryshme sportive, si dhe promovimi i sportit dhe sigurimi i kushteve për vajzat dhe vajzushat që të merren me sport, dhe më pas si femra të qëndrojnë në profesion sportiv. Për të arritur këtë, ne kemi nevojë për mbështetjen financiare të klubeve të femrave, prishjen e stereotipit se sporti është një fushë "mashkullore", duke përfshirë më shumë trajnerë femra, si dhe vendosjen e masave për të luftuar dhunën dhe seksizmin në sport. Integrimi i perspektivës gjinore është i rëndësishëm edhe gjatë ndërtimit të objekteve sportive, respektivisht ato duhet të përshtaten, të jenë të sigurta, të pajisura që t'u mundësohet shfrytëzim i tyre nga vajzat dhe femrat.

### **Kultura**

Përcaktimi i prioritetëve në avancimin e barazisë gjinore në kulturë fillon nga fakti se e drejta për kulturë është një e drejtë themelore dhe e pacenueshme e njeriut, dhe kultura dhe arti janë kryesore në ndërtimin e vlerave në shoqëri. Gjendja e kulturës duhet të përmirësohet në mënyrë që të mbështesë dhe promovojë projekte, vepra dhe ngjarje që promovojnë barazinë gjinore, tolerancën dhe pranimin e identitetëve të ndryshme gjinore, duke siguruar qasje dhe mbështetje të barabartë për autorët dhe bartësve të projekteve, si dhe përfaqësim më të madh të femrave në pozicione më autoritare dhe më të paguara.

### **Media**

Prioritetet në sferën e mediave duhet të fokusohen në promovimin e barazisë gjinore në programe dhe përmbajtje, duke paraqitur shembuj pozitivë, angazhim më të shpeshtë të femrave si bashkëbiseduese në debat dhe programe të tjera me të ftuar, si dhe përfaqësim më të madh të përmbajtjes që trajton tema të barazisë gjinore, respektivisht përfshirja e aspektit gjinor në numrin më të madh të temave që përpunohen në media. Për atë qëllim, nevojitet një përfaqësim më i madh i femrave në pozita vendimmarrëse, redaktore dhe drejtore, si dhe edukim dhe ngritje të vetëdijes për çështjet gjinore tek të gjithë punonjësit e medias.


### **Seksizmi dhe dhuna në bazë gjinore**

Seksizmi dhe dhuna me bazë gjinore janë të lidhura ngushtë, ashtu që çrrënjësja e dhunës dhe avancimi i pozitës së femrave në sfera të tjera duhet të vijë nga lufta kundër seksizmit dhe stereotipizimi i roleve gjinore. Në këtë drejtim, aktorë të rëndësishëm janë media, arsimiti, sporti dhe ngjarjet kulturore. Nevojitet të promovohet barazi dhe toleranca në përmbajtjen e mësimdhënies dhe mediave dhe të sanksionohet në mënyrë efektive gjuha seksiste e urrejtjes. Për këtë, është e nevojshme të ndërtohen kapacitetet e punonjësve në këto sfera dhe të sensibilizohet popullata për të njohur këto fenomene.

Lidhur me dhunën me bazë gjinore, është e nevojshme që të respektohen plotësisht standardet e KE-së, për sa i përket zgjidhjeve ligjore, shërbimeve në dispozicion dhe shërbimet mbështetëse, masat parandaluese, si dhe masat për ndëshkimin e autorëve, përfshirë autorët e ngacmimit seksual dhe ngacmimeve kibernetike. Përveç kësaj, nevojitet mbledhje sistematike e të dhënave përkatëse të ndara sipas gjinisë.

Lidhur me trafikimin me njerëz, nevojitet të forcohen kapacitetet e policisë, të punonjësve socialë dhe aktorëve tjerë në strukturat për këtë problematikë, në mënyrë që të identifikohen në mënyrë më efektive viktimat dhe të ofrohet mbrojtje dhe mbështetje.

## PASQYRË SKEMATIKE





**QËLLIMET DHE REZULTATET E PRITURA****Qëllimi kryesor 1. VENDOSJA E SISTEMIT EFEKTIV DHE EFIKAS PËR AVANCIMIN E BARAZISË GJINORE NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL**

**Qëllimi specifik 1.1:** Avancimi i mekanizmave për barazi gjinore në nivel qendror dhe lokal, në pajtim me kornizën ligjore për avancimin e barazisë gjinore

Rezultatet e pritura	Indikatorë
1.1.1 Avancimi i mekanizmave për barazi gjinore në nivel qendror	Vendosja e trupit të veçantë për barazi gjinore në nivel të Qeverisë, me qëllime dhe detyra konkrete Sistematizimi i vendit të punës koordinator/re për mundësi të barabarta me përgjegjësitë dhe kompetencat e përcaktuara Të punësuar në vendin e punës koordinator/e dhe zëvendëskoordinator/e, sipas gjinisë, sipas kualifikimeve
1.1.2 Krijimi i mekanizmit për ndërtimin e vazhdueshme të kapaciteteve të administratës publike në lidhje me barazinë gjinore në nivelin qendror dhe lokal, përfshirë kryetarët e komunave	Module të zhvilluara dhe të standardizuara për trajnim Përcaktimi i planit dhe programit për trajnim Numri i personave të trajnuara nga administrata publike, sipas nivelit, sipas gjinisë

**Qëllimi specifik 1.2:** Vendosja e sistemit funksional për kyçjen e perspektivës gjinore në krijimin e politikave, programeve dhe proceseve buxhetore në nivel qendror dhe lokal

Rezultatet e pritura	Indikatorë
1.2.1 Kapacitetet e BPGJ janë avancuar në të gjitha nivelet e hartimit të politikave dhe buxheteve	Vendosje e Qendrës së Burimeve dhe Qendra për informime për krijimin e përgjegjësisë gjinore Politikat dhe buxhetimi Sistemi i vendosur për trajnime për BPGJ për indikatorët në të gjitha nivelet Persona të trajnuar për BPGJ në administratë publike, në nivel qendror, sipas gjinisë, sipas vitit
1.2.2 Femrat dhe nevojat dhe kërkesat e tyre përfshihen në hartimin e politikave, programeve dhe buxheteve, në nivel lokal	Pjesëmarrës në Forume në Komunitet dhe forma të tjera të pjesëmarrjes qytetare, sipas gjinisë - Numri i politikave, programeve dhe buxheteve që janë miratuar përmes përdorimit të veglave participative
1.2.3 Shfrytëzim sistematik dhe i qëndrueshëm i buxhetimit me përgjegjësi gjinore si vegël nga përdoruesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal	- Numri i programeve që përfshijnë masa specifike gjinore dhe alokime buxhetore

Qëllimi specifik 1.3: Krijimi i një sistemi efikas për përcjelljen e situatës me barazinë gjinore, në përputhje me detyrimet dhe rekomandimet përkatëse ndërnacionale

<u>Rezultatet e pritura</u>	<u>Indikatorë</u>
1.3.1 Mbledhje dhe azhurnim i rregullt i të dhënave të ndara sipas gjinisë në të gjitha nivelet dhe me të gjithë aktorët përkatës	- Baza e të dhënave në nivel qendror, me të dhëna të ndara sipas gjinisë, publikisht dhe lehtësisht të arritshme
1.3.2 Indikatorë matës të ndjeshëm gjinorë për përcjelljen e situatës me barazi gjinore	- Numri i politikave dhe programeve që përmbajnë indikatorë të ndjeshëm ndaj gjinisë
<u>Indikatorë</u>	

Qëllimi specifik 1.4: Implementimi i perspektivës gjinore në punë dhe krijimi i masave dhe programeve në kohë të kushteve të jashtëzakonshme dhe në gjendje krize në nivel qendror dhe lokal

<u>Rezultatet e pritura</u>	<u>Indikatorë</u>
1.4.1 Struktura të balancuara gjinore që mbajnë masa të ndjeshme gjinore që marrin parasysh nevojat e ndryshme të femrave dhe të meshkujve në kohë krize dhe gjendje të jashtëzakonshme	- Numri i femrave në strukturat vendimmarrëse në gjendje të jashtëzakonshme dhe në gjendje krize - Numri i ekspertë(e)ve për çështje gjinore, që marrin pjesë (konsultohen) në krijimin e masave - Numri i masave të senzitive gjinore të miratuara
1.4.2 Mekanizma të vendosur për integrimin e politikave për barazi gjinore në gjendje krize dhe të jashtëzakonshme	- Analizë e përgatitur gjinore e buxhetit dhe alokimet nga buxheti qendror dhe lokal - Është miratuar plani nacional i krizës me protokolle dhe strategji të hollësishme, me qasje kryqëzimi - Metodologji e krijuar për vlerësimin e ndikimit të krizës tek femrat dhe meshkujt

Qëllimi i përgjithshëm 2. PËRMIRËSIMI I POZITËS SË FEMRAVE NË TË GJITHA SFERAT E JETËS PUBLIKE DHE PRIVATE

Qëllimi specifik 2.1: Zvogëlimi i hendekut gjinor në pjesëmarrjen ekonomike të femrave dhe tregun e punës, me qasje ndërseksionale

Rezultatet e pritura	Indikatorë
2.1.1 Rritja e aktivizimit të femrave dhe zvogëlimi i pabarazisë gjinore në tregun e punës, me një fokus të veçantë tek femrat nga komunitetet e marginalizuara	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përqindja e popullsisë aktive (15+), sipas gjinisë</li> <li>- Shkalla e punësimit (popullsia 15+), sipas gjinisë</li> <li>- Numri i femrave të papuna të regjistruara në APRMV</li> <li>- Përqindja e shfrytëzimit të masave për punësim, sipas gjinisë, sipas shkallës së arsimit</li> </ul>
2.1.2 Hendeku gjinor në paga është zvogëluar përmes masave adekuata	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përqindja e hendekut gjinor në paga (e pa përshtatur)</li> </ul>
2.1.3 Zvogëlimi i strategjisë sektoriale dhe hierarkike të vendeve të punës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe punë sociale, sipas gjinisë</li> <li>Femra (%) në pozita udhëheqëse në arsim, shërbime shëndetësore dhe sociale</li> <li>- Të punësuar sipas statusit ekonomik, sipas gjinisë</li> </ul>
2.1.4 Përmirësimi i cilësisë së punës së femrave	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të punësuarit me orar të plotë pune, sipas gjinisë</li> <li>- Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, sipas gjinisë</li> </ul>
2.1.5 Masat e vendosura për harmonizimin e jetës profesionale dhe private, në përputhje me Direktivën e BE-së mbi balancën e jetës profesionale dhe private	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të punësuarit (15+) me fleksibilitet në orarin e punës, sipas gjinisë, sipas moshës</li> <li>- Përfaqësimi i serviseve të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit, nëpër komuna</li> <li>- Fëmijët (%) të perkujdesur në shërbimet formale për kujdes</li> <li>Koha (%) e kaluar në aktivitetet në amvisëri, sipas gjinisë</li> <li>- Vendosje e patransferueshme e pushimit prindëror për meshkuj</li> <li>Hendeku gjinor në punësim të prindërit e fëmijëve nën moshën 6 vjeçare</li> <li>- Femra dhe meshkuj (%) që nuk kërkojnë punë për shkak të kujdesit familjar</li> </ul>
2.1.6 Masa të ndjeshme gjinore për të zbutur pasojat nga gjendja e krizës gjendjet e jashtëzakonshme mbi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i masave të ndjeshme gjinore</li> <li>- Numri i masave që synojnë sektorët ku femrat dominojnë si</li> </ul>

femrat në ekonomi	të punësuara: në hotelieri, shërbime personale dhe kujdes higjienik, tregti me shumicë dhe pakicë, industrinë e përpunimit
-------------------	--

Qëllimi specifik 2.2: Avancimi i pozitës së femrave në bujqësi përmes masave dhe politikave të veçanta që synojnë afirmimin dhe vlerësimin përkatës të punës së tyre

Rezultatet e pritura	Indikatorët
2.2.1 Pozicioni i përmirësuar i femrave në mjediset rurale për sa i përket menaxhimit të pronës bujqësore dhe tokës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Femrat (%) bartëse të ekonomive nga numri i përgjithshëm</li> <li>- Femrat (%) nga mjediset rurale pronare të pronës</li> <li>- Numri i femrave që ushtrojnë në mënyrë të pavarur veprimtari bujqësore</li> <li>- Numri i fushatave të zbatuara për ndërgjegjësimin për të drejtën e pronës dhe trashëgimisë</li> </ul>
2.2.2 Zvogëlimi i punës së papaguar të bërë nga femrat në mjediset rurale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Femrat (%) në ekonominë joformale, që kanë sigurim shëndetësor dhe/ose social</li> <li>- Numri i shërbimeve për fëmijët dhe të moshuarit në mjediset rurale, sipas komunave</li> <li>- Numri i masave të miratuara për formalizimin e punës joformale</li> </ul>
2.2.3 Rritja e pjesëmarrjes së femrave në programet e mbështetjes financiare në bujqësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja e femrave (%) si bartëse të aplikacioneve për mbështetjen financiare</li> <li>- Femrat (%) bartëse të aplikacioneve që morën mbështetje financiare</li> </ul>
2.2.4 Të rinjtë të motivuar të merren me bujqësi përmes masave stimuluese dhe mbështetjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bartësit e ekonomive bujqësore, sipas moshës, sipas gjinisë</li> <li>- Të rinjtë (%) lidhur me bartësit e moshuarit të ekonomive, sipas gjinisë</li> <li>- Numri i masave stimuluese të orientuar për të rinjtë në bujqësi</li> </ul>

Qëllimi specifik 2.3: Forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe krijimin e politikave të përgjegjshme gjinore për ndryshimet klimatike dhe politikave të rezistueshme klimatike për barazi gjinore

Rezultatet e pritura	Indikatorët
<p>2.3.1 Aspekti gjinor është i integruar në masat dhe politikat për të zbutur dhe përshtatur me ndikimin e ndryshimeve klimatike</p> <p>2.3.2 Aspekti gjinor përfshihet në sistemin për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkallës së zbatimit të aksioneve klimatike _____</p> <p>2.3.3 Aspekti gjinor përfshihet në politikat nacionale dhe lokale, në kriteret e subvencionimit dhe në mbështetjen financiare që lidhen me aksionet klimatike strategjike</p> <p>2.3.4 Forcimi i kapaciteteve për aspektin gjinor të ndryshimeve klimatike në <u>nivelin nacional dhe lokal</u></p> <p>2.3.5 Grupet e cenueshme të femrave mbrohen nga ndikimet e ndryshimeve klimatike përmes qasjes së barabartë në sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve dhe në mekanizmat financiar për mbulimin e dëmeve</p> <p><u>Qëllimi specifik 2.4:</u> Pjesëmarrja e barabartë e femrave në miratimin e vendimeve në të gjitha nivelet në jetën politike dhe publike</p>	<p>Numri i masave dhe politikave me aspektin e integruar gjinor (në energjetikë, bujqësi, burime ujore dhe transport)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i indikatorëve gjinorë të përfshirë në sistem</li> <li>- Numri i politikave nacionale dhe lokale në energjetikë, bujqësi, burime ujore dhe transport, që përfshijnë aspektin gjinor</li> <li>- Numri i femrave që kanë marrë subvencione / mbështetje nga Qeveria ose nga komunat në energjetikë, bujqësi, burime ujore dhe transport</li> <li>- Numri i trajnimeve, sipas sektorëve</li> <li>- Numri i personave të trajnuar, sipas gjinisë</li> <li>- Personat që përdorin masa për zvogëlimin e rreziqeve, sipas gjinisë</li> <li>- Numri i masave që u orientohen drejtpërdrejt kategorive të cenueshme të femrave</li> </ul>

Rezultatet e pritura	Indikatorët
<p>2.4.1 Femrat marrin pjesë në mënyrë të barabartë në sferat e miratimit të vendimeve në nivelet më të larta nacionale të <u>menaxhimit (Angazhimi 50-50)</u></p> <p>2.4.2 Rritja e përfaqësimit të femrave në organet e vendimmarrjes brenda administratës, gjegjësisht hartuesit e politikave <u>brenda fushës</u></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfaqësimi i femrave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (%)</li> <li>- Përfaqësimi i femrave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (%)</li> <li>- Të punësuarit në sektorin publik, sipas gjinisë, sipas institucionit</li> <li>- Femrat (%) në pozitat udhëheqëse në institucionet, ndërmarrjet publike, ministrinë</li> </ul>

2.4.3 Rritja e pjesëmarrjes së femrave në krijimin e politikave dhe buxheteve lokale, veçanërisht kategorive të cënueshme të femrave (Angazhimi 50-50)

2.4.4 Rritja e pjesëmarrjes së femrave në pozicionet e miratimit të vendimeve në mediat

2.4.5 Rritja e përfaqësimit të femrave në strukturat e vendimarrjes në sport - 40% e femrave në organet drejtuese (asamble, KD, KE) deri në vitin 2026

2.4.6 Përmirësimi i pozitës së femrave në partitë politike përmes masave detyruese dhe jodetyruese stimuluese

- Femrat (%) kandidatë për kryetare të komunës
- Femrat (%) u zgjedhën kryetare të komunës
- Anëtarë të këshillave komunalë, sipas gjinisë
- Femrat (%) që udhëheqësin këshilla komunalë
- Përfaqësimi i këshilltareve në këshillat (\*)
- Kandidatë për këshilltarë komunalë, sipas gjinisë
- Pronarët e televizioneve dhe radiostacioneve, sipas gjinisë, sipas pronësisë
- Redaktorët dhe drejtorët e mediave, sipas gjinisë
- Gazetarët e punësuar, sipas gjinisë
- Anëtarët e organeve drejtuese në federatat nacionale të sportit, Komitetin Olimpik të Maqedonisë dhe strukturat e tjera sportive, sipas gjinisë, sipas pozitës
- Femrat (%) në partitë politike
- Mosha e personave në pozitat udhëheqëse në parti, sipas gjinisë
- Shkalla e arsimimit të këshilltarëve, sipas gjinisë
- Femrat e listave të kandidatëve, sipas partive
- Mjetet (%) e buxhetit publike të shfrytëzuara nga partitë për financimin e degës së femrave, sipas partisë

#### Qëllimi specifik 2.5: Qasja e barabartë në mbrojtjen shëndetësore për të gjitha femrat

##### Rezultatet e pritura

2.5.1 Qasja e barabartë në shërbimet shëndetësore gjatë shtatzënisë

##### Indikatorët

- Numri i ambulancave gjinekologjike (të lëvizshme), sipas rajoneve dhe komunave
- Numri i gjinekologëve me marrëveshjen e lidhur me Fondin, sipas komunave
- Femrat shtatzënë (%) që kanë qasje dhe dobi nga kujdesi prenatal dhe postnatal
- Numri i vizitave të infermiereve patronazhe
- Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave
- Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç
- Numri i kontrolleve gjatë shtatzënisë (mesatarisht)

2.5.2 Rritja e mbulimit të femrave me kontrollet parandaluese të parashikuara nga Programi për detektimin e hershëm të sëmundjeve malinje (skriningu për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës; skriningu i kancerit kolorektal; skriningu mamofemrafike për detektimin e hershëm të kancerit të gjirit)

2.5.3 Femrat kanë qasje të lehtë në shërbimet cilësore të planifikimit familjar dhe zgjedhjen e mjeteve dhe metodave kontraceptive dhe moderne

2.5.4 Mbështetja dhe ndihma e plotë shëndetësore për femrat gjatë menopauzës, pas periudhës riprodhuese

2.5.5 FAB në dispozicion për të gjitha femrat, pavarësisht nga lloji i komunitetit dhe statusit financiar

2.5.6 Ndhimja dhe mbështetja e plotë shëndetësore për shëndetin mendor të vajzave, femrave dhe personave me identitet të ndryshëm gjinor

Përfshirja e femrave (% / numri) me skrining të organizuar për kancerin e fytit të mitrës, gjithsej, sipas viteve

Përfshirja e femrave (% / numri) me skrining mamofemrafik për detektimin e hershëm të kancerit të gjirit, gjithsej, sipas viteve

Përfshirja e femrave (% / numri) me skrining të kancerit kolorektal, gjithsej, sipas viteve

Numri i kuadrove që ofrojnë shërbime gjinekologjike, përfshirë parandalimin e HPV dhe testimin PAP (patologë, citologë, etj.)

Disponueshmëria e abortit mjekësor

Masat e vendosura për disponueshmërinë e abortit për femrat e rrezikuara sociale, me numrin dhe përqindjen e shfrytëzimit

Përdorimi i mjeteve kontraceptive, sipas gjinisë, sipas moshës

Numri i mjeteve kontraceptive të vendosura në listën pozitive të FSSHМ-së

Programet dhe udhëzimet e vendosura për këshillimin e rregullt nga gjinekologët / mjekët amë, sipas numrit dhe disponueshmërisë sipas komunave

Përfshirja (%) e femrave me pakon e detyrueshme shëndetësore falas për femrat mbi

35 vjeçe, sipas moshës, sipas komunave

Disponueshmëria e informatave të dukshme dhe të kuptueshme në faqet e internetit të Fondit, Ministrisë, Institutit, Qendrës për Shëndetin Publik Femrat që kanë bërë procedurë së FAB-së, pas llojit të komunitetit

Udhëzimet dhe programet e vendosura për këshillimin dhe referimin në mjekët amë

Informatat e disponueshme dhe të kuptueshme në faqet e internetit të MSH-së, Institutit, Qendrës për Shëndetin Publik

Numri i institucioneve / qendrave / qendrave këshilluese për mbështetje psikologjike, që kanë lidhur marrëveshje me Fondin

Qëllimi specifik 2.6: Arsimimi dhe shkenca me ndjeshmëri gjinore

Rezultatet e pritura	Indikatorët
2.6.1 Përfshirja dhe parandalimi i shtuar i braktisjes së hershme të procesit arsimor nga vajzat nga komunitetet e marginalizuara	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Personat që kanë lënë arsimin, sipas gjinisë, sipas përkatësisë etnike</li> <li>- Numri i fëmijëve të lindur të gjallë nga nënat nën 15 vjet, sipas komunave</li> <li>- Numri i fëmijëve të lindur të gjallë nga nënat e moshës prej 15 deri në 19 vjet, sipas komunave</li> <li>- Numri i martesave të lidhura në mes të</li> </ul>
2.6.2 Formimi (shtesë) i arsimit fillor për femrat rome të rritura dhe mbështetje përmes pjesëmarrjes në trajnime sipas programeve të verifikuara të marrjen e kualifikimeve, me qëllim të rritjes së qasjes në tregun e punës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i femrave rome të rritura që kanë mbaruar arsimin fillor</li> <li>- Numri i femrave rome të përfshira në trajnime sipas programeve të verifikuara për marrjen e kualifikimeve</li> </ul>
2.6.3 Parimi i promovuar i barazisë gjinore në veprimtarinë hulumtuese shkencore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentë të diplomuar, sipas gjinisë, sipas profesionit</li> <li>- Doktorë shkencash, sipas gjinisë, sipas profesionit</li> <li>- Profesorë në arsimin e lartë, sipas gjinisë, sipas moshës</li> </ul>
2.6.4 Segregacioni i zvogëluar në fushat që konsiderohen të "femrave" dhe të "meshkujve" dhe zvogëlimi i hendekut gjinor në teknologjitë informatike dhe të komunikimit (TIK) dhe shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentë në arsimin e lartë, sipas fushave, sipas gjinisë</li> <li>- Studentë të regjistruar dhe të diplomuar në fushat e TIK-së dhe STEM-së, sipas gjinisë</li> <li>- Vajzat dhe djemtë (%) në arsimin fillor dhe të mesëm që presin të punojnë në TIK</li> <li>- Ndarja e bursave, sipas gjinisë, sipas fushës</li> </ul>
2.6.5 Arsimi seksual gjithëpërfshirës i vendosur plotësisht	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fushëveprimi i ASGJ-së, sipas numrit të shkollave, sipas komunave</li> <li>- Numri i mësimeve të trajnuar të ASGJ-së, sipas gjinisë, sipas komunave</li> </ul>
2.6.6 Infrastruktura e ndjeshme gjinore në shkolla (gjatë ndërtimit / rinovimit merren parasysh nevojat e ndryshme të vajzave)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i shkollave me tualete të arritshme dhe të rregulluara siç duhet për mbajtjen e higjienës menstruale (hapësirë e sigurt, e pastër dhe private me sapun dhe ujë, letër për fshirje dhe</li> </ul>



пër mbeturina menstruale)

- Arritja e produkteve higjienike në shkolla (%)

Qëllimi specifik 2.7: Avancimi i barazisë gjinore për të arritur dhe mbajtur paqen pozitive (femrat, paqja dhe siguria)

Rezultatet e pritura

2.7.1 Rritja e pjesëmarrjes së femrave në fushën e mbrojtjes, veçanërisht në pozicionet e miratimit të vendimeve

2.7.2 Personeli i ndjeshëm gjinor në mbrojtje, politikën e jashtme dhe punët e brendshme

2.7.3 Rritja e pjesëmarrjes së femrave në politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërnacionale dhe në misionet dhe operacionet paqësore dhe humanitare ndërnacionale, si dhe në projektet shkencore me interes për mbrojtjen

2.7.4 Rritja e numrit të femrave të punësuar në polici

Indikatorët

- Të punësuarit në mbrojtje, sipas gjinisë, sipas pozicioneve të punës, sipas kategorive
- Disponueshmëria e programeve / moduleve arsimore të ndara dhe të integruara, sipas institucionit
- Tema e paraqitur e veçantë mbi barazinë gjinore në trajnime
- Të punësuarit që kanë kaluar trajnime për barazinë gjinore, sipas gjinisë, sipas institucionit
- Femrat (%) në misionet dhe operacionet paqësore dhe humanitare
- Të punësuarit në përfaqësitë e jashtme (ambasada / konsullata), sipas gjinisë, sipas pozicionit
- Të punësuarit në drejtoritë e MPJ-së, sipas gjinisë, sipas pozitës
- Pjesëmarrja në projektet shkencore (NATO), sipas gjinisë, sipas pozitës
- Të punësuarit në vendin e punës "polic", sipas gjinisë
- Të punësuarit në shërbimet e MPB-së, sipas gjinisë, sipas gradës, sipas shërbimit
- Kandidatë për vendin e punës "polic" të dërguar për trajnim, sipas gjinisë

Qëllimi specifik 2.8: Përmirësimi i qasjes në shërbimet sociale dhe promovimi i perspektivës gjinore për siguri sociale

Rezultatet e pritura

2.8.1 Masat specifike të vendosura dhe të avancuara për kategoritë e prekshme të femrave dhe personave me identitete të ndryshme gjinore, me vëmendje të veçantë ndaj interseksionalitetit

Indikatorët

- Numri i masave të mbrojtjes sociale të orientuar drejt femrave, sipas kategorisë së cenueshmërisë
- Fushëveprimi (%) i femrave me masat e orientuara drejt kategorive të cenueshme

<p>2.8.2 Përmirësimi i kapaciteteve të të punësuarve socialë dhe mbulimi me shërbimet sociale në dispozicion në mjediset rurale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpërndarja e qendrave për punë sociale, sipas komunave</li> <li>- Përfshirja e popullsisë (%/numri) sipas qendrave për punë sociale</li> <li>- Vendosija e programit të trajnimit mbi çështjet gjinore për të punësuarit socialë</li> <li>- Të punësuarit socialë të cilët janë trajnuar mbi çështjet gjinore, <u>sipas gjinisë, sipas rajonit</u></li> </ul>
<p>2.8.3 Integrimi i perspektivës gjinore me fokus në interseksionalitetin në analizën e nevojave në krijimin e programeve të mbështetjes së gjendjeve të krizës dhe të jashtëzakonshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i masave që synojnë kategoritë e prekshme të femrave</li> </ul>

**Qëllimi specifik 2.9:** Qasja e barabartë në drejtësi për të gjitha femrat dhe meshkujt

<u>Rezultatet e pritura</u>	<u>Indikatorët</u>
<p>2.9.1 Ligjet, masat dhe politikat sigurojnë qasje të barabartë në drejtësi për femrat nga <u>kategoritë e prekura</u></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshirja (%) e personave që kanë shfrytëzuar NJF, sipas gjinisë, sipas identitetit gjinor, në bazë të kërkesës</li> </ul>
<p>2.9.2 Kushtet e përmirësuara për femrat në repartet e femrave nëpër burgje</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qasja në shërbimet shëndetësore dhe gjinekologjike në repartin e femrave në IP Idrizovë</li> <li>- Vendosija e programeve arsimore dhe profesionale <u>në fushën e arsimit</u></li> </ul>
<p>2.9.3 Përmirësimi i njohurive dhe ndërgjegjësimit të praktikuesve juridikë (gjykatësit, prokurorët publikë, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, avokatët dhe juristët e rinj) mbi konceptet në fushën e barazisë gjinore dhe antidiskriminimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosija e sistemit të trajnimeve për praktikuesit juridikë</li> </ul> <p>Personat që ndoqën trajnimin, sipas gjinisë, sipas profesionit, sipas sektorit të punës gjinore në sport</p>

**Qëllimi specifik 2.10:** Avancimi i barazisë

<u>Rezultatet e pritura</u>	<u>Indikatorët</u>
<p>2.10.1 Rritja e pjesëmarrjes së femrave dhe vajzave në aktivitetet sportive rekreative dhe profesionale përmes programeve përkatëse dhe masave stimuluese</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Personat që merren me sport, në mënyrë rekreative dhe profesionale, sipas gjinisë, sipas moshës, sipas llojit të sportit</li> <li>- <u>Koha (orët) e huazimit të terreneve sportive,</u></li> </ul>

	sipas strukturës gjinore të ekipeve - Numri i objekteve sportive, sipas komunës, sipas llojit
2.10.2 Masat e vendosura për të mbështetur femrat për mbajtjen e tyre në profesionin e sportit	- Numri i femrave trajnere, sipas sporteve - Trajnerë të punësuar sipas evidencës së ARS-së, sipas gjinisë, sipas sportit
2.10.3 Rritja e mbështetjes financiare në nivelin qendror dhe lokal për klubet sportive të femrave dhe sportistet	- Pjesa e buxheteve të ARS-së dhe komunave për financimin e klubeve të femrave dhe sportistëve - Numri i klubeve të femrave dhe sportistëve që morën mbështetje financiare
2.10.4 Të punësuarit e trajnuar dhe të ndjeshëm gjinorë në strukturat sportive	- Vendosja e trajnimeve për barazi gjinore për të punësuarit në strukturat sportive - Numri i personave të trajnuar, sipas gjinisë, sipas strukturës

## Qëllimi specifik 2.11: Avancimi i barazisë gjinore në kulturë

Rezultatet e pritura	Indikatorët
2.11.1 Rritja e pjesëmarrjes së femrave në projektet në fushën e kulturës	- Zë i veçantë i veçuar për financimin e projekteve, bartës të cilave janë femrat - Bartësit e projekteve të financuara nga Ministria e Kulturës, sipas gjinisë, sipas tematikës
2.11.2 Çështjet gjinore janë më të dukshme në ngjarjet kulturore dhe në botimet në fushën e kulturës	- Zë i veçantë i financimit të veprave / projekteve që kanë të bëjnë me çështjet gjinore - Numri i hulumtimeve dhe analizave të përpunuara dhe të publikuara mbi gjininë dhe politikat gjinore në kulturë - Numri i ngjarjeve të organizuara në institucionet publike të financuara nga MQ që janë përqendruar në gjininë dhe identitetet gjinore
2.11.3 Autore të promovuara në letërsinë maqedonase dhe veprat e përkthyer nga autore të huaja	- Autorë të librave të botuar me mbështetje financiare nga MQ, sipas gjinisë - Përkthyes të librave të botuar me mbështetje financiare nga MQ, sipas gjinisë
2.11.4 Punëtorë profesionistë të ndjeshëm gjinorë në institucionet	- Numri i trajnimeve të ndjekura, sipas institucionit / shërbimit,

Qëllimi i përgjithshëm 3. ÇRRËNJOSJA E STEREOTIPAVE GJINORE DHE NDËRTIMI I KULTURËS SË JODHUNËS DHE MOSDISKRIMINIMIT BAZUAR NË GJININË DHE IDENTITETIN GJINOR

Qëllimi specifik 3.1: Parandalimi dhe lufta kundër dhunës të bazuar në gjini

Rezultatet e pritura	Indikatorët
3.1.1 Rregullativa e harmonizuar ligjore me standardet e vendosura nga Konventa e Stambollit, duke përfshirë të gjitha format e DHBGJ-së dhe shqetësimit seksual	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkalla e harmonizimit të legjislacionit nacional me KS-në</li> <li>- Ndryshimet në Kodin Penal në përputhje me KS-në</li> </ul>
3.1.2 Të dhënat e ndara sipas gjinisë në dispozicion për të gjitha	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi i vendosur për mbledhjen sistematike të të dhënave</li> </ul>
3.1.3 Përgjigjja e avancuar institucionale ndaj parandalimit dhe mbrojtjes nga DHBGJ-ja, veçanërisht ndaj policisë dhe gjyqësorit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi i vendosur për trajnimet e rregullta të të punësuarve në institucionet për njohjen dhe veprimin në lidhje me format e ndryshme të DHBGJ-së</li> <li>- Numri i trajnimeve të zbatuara, sipas institucionit</li> <li>- Numri i nëpunësve shtetërorë që kanë ndjekur trajnim, sipas gjinisë, sipas institucionit</li> <li>- Numri i rasteve sipas të cilave ka vepruar MPB-ja dhe PTHP-ja në lidhje me shqetësimin seksual dhe ndjekjen në internet, veçmas</li> </ul>
3.1.4 Disponueshmëria dhe qasja e shtuar në shërbimet e specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shërbimet e vendosura, sipas rajonit</li> <li>- Fushëveprimi i viktimave të shërbimit, sipas shërbimit, sipas komunës, sipas rajonit</li> <li>- Numri i shërbimeve në dispozicion për femrat me aftësi të kufizuara, sipas komunës</li> <li>- Shërbimet në dispozicion në gjuhë të tjera, sipas shërbimit</li> </ul>
3.1.5 Sistemi i forcuar për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit me njerëz, me theks në flukset e emigrantëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i personave të identifikuar, sipas gjinisë, origjinës, lëvizjes</li> <li>- Numri i shërbimeve të akomodimit dhe mbështetjes për viktimat e trafikimit me njerëz, sipas rajonit</li> <li>- Numri i shërbimeve për akomodimin e femrave dhe fëmijëve gjatë migrimit ilegal</li> <li>- Të punësuarit në sektorin e tregtisë me njerëzit që ndoqën trajnimin, sipas institucionit, sipas gjinisë, sipas sektorit</li> </ul>

Qëllimi specifik 3.2: Parandalimi i stereotipave gjinore dhe seksizmit dhe promovimi i barazisë

Rezultatet e pritura	Indikatorët
3.2.1 Zero tolerancë ndaj seksizmit dhe gjuhës seksiste të urrejtjes në vendet e punës, në sport, në media dhe në qasjen ndaj të mirave dhe shërbimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbatimi i standardeve ndërnacionale për luftën kundër seksizmit në masat dhe politikat</li> <li>- Vendosja e udhëzimeve për të reaguar gjatë shfaqjes së gjuhës seksiste të urrejtjes, sipas fushave</li> <li>- Numri i paralajmërimeve / reagimeve në media</li> <li>- Numri i paralajmërimeve / reagimeve në ngjarjet sportive</li> <li>- Numri i paraqitjeve të seksizmit në vendin e punës, sipas gjinisë, sipas identitetit gjinor</li> <li>- Numri i ankesave dhe parashtresave për seksizmin në qasjen në të mirat dhe shërbimet</li> </ul>
3.2.2 Arsimi dhe materialet mësimore që promovojnë barazinë, tolerancën dhe mosdiskriminimin	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Është vendosur mekanizmi efikas për revidimin e përmbajtjeve të vjetra dhe krijimin e përmbajtjeve të reja në programet mësimore, librat shkollore dhe materialet didaktike që janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të cilat promovojnë pikëpamje pozitive ndaj gjinisë dhe identiteteve gjinore, me qasje ndërseksionale</li> <li>- Numri i programeve të reja dhe të reviduara mësimore, teksteve shkollore dhe materialeve didaktike</li> </ul>
3.2.3 Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në lidhje me barazinë gjinore, duke përfshirë qasjen ndërseksionale, mes mësimdhënësve, edukatorëve, shërbimit psikologjik dhe pedagogjik dhe drejtorëve në shkolla dhe kopshte	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i trajnimeve të ndjekura, sipas gjinisë, sipas shërbimit</li> </ul>
3.2.4 Fëmijët fillojnë të mësojnë për barazinë gjinore, tolerancën dhe mosdiskriminimin që në moshë të re	<ul style="list-style-type: none"> <li>- U futën përmbajtjet për të promovuar barazinë gjinore dhe kulturën e jodhunës në kopshte dhe në shkolla</li> <li>- Përfshirja e kopshteve dhe shkollave me trajnime për barazinë gjinore, sipas komunave</li> </ul>

<p>3.2.5 Mediat që nuk promovojnë stereotipa dhe role stereotipike, por barazi dhe diversitetet gjinor</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i trajnimeve për të punësuarit mediatikë dhe të punësuarit në institucionet në lidhje me stereotipat gjinore, sipas gjinisë, sipas shërbimit</li> <li>- Numri i parashtresave të paraqitura për përmbajtje diskriminuese në mediat</li> <li>- Përfaqësimi (%) në tema me barazinë gjinore dhe diversitetet në përmbajtjet mediatike</li> <li>- Përfaqësimi (%) i femrave bashkëbiseduese në emisionet televizive</li> <li>- Përfaqësimi (%) i femrave në përmbajtjet mediatike</li> <li>- Qëndrimet ndaj përmbajtjeve me dallimet gjinore në mediat, sipas gjinisë, sipas moshës (kontrolli periodik)</li> </ul>
<p>3.2.6 Institucionet që përfshijnë konceptin e barazisë inkluzive dhe e zbatojnë duke përmbushur detyrimin për të promovuar barazinë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i masave ose veprimeve të ndërmarra për të promovuar dhe avancuar barazinë dhe parandalimin e diskriminimit në përputhje me Ligjin e Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe Udhëzimet për detyrat e sektorit publik në promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit</li> </ul>

#### BUXHETI I STRATEGJISË

Implikimet fiskale për zbatimin e Strategjisë do të jenë pjesë e planeve operative të ministrive resoriale në lidhje me aktivitetet e planifikuara, përmes proceseve të planifikimit të buxhetit në nivel vjetor. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e planifikimit të buxhetit janë donatorët dhe mbështetësit ndërnacionalë multilateralë dhe bilateralë.

#### ZBATIMI I STRATEGJISË

Për të arritur qëllimet dhe rezultatet e Strategjisë, janë përfshirë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrinë dhe organet e tjera të administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe të gjithë faktorët nga organizatat sportive, kulturore, ekonomike dhe të tjera. Është me rëndësi të veçantë përfshirja e organizatave qytetare në zbatimin e Strategjisë, veçanërisht ato që punojnë në fushën e barazisë gjinore, për të krijuar partneritet të vërtetë në avancimin e situatës. Gjithashtu, të rëndësishme për zbatimin e Strategjisë dhe për arritjen e qëllimeve janë organizatat ndërnacionale që mbështesin vendin në përparimin dhe harmonizimin me standardet, politikat dhe praktikat ndërnacionale.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të jetë përgjegjëse për koordinimin e zbatimit të Planit Nacional të Veprimit 2021 - 2023 dhe planeve operative vjetore për zbatimin e Strategjisë.

**Ndjekja e zbatimit**

Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale do të ndjek zbatimin e Strategjisë. Meqë zbatimi i Strategjisë mbulon fusha të ndryshme të masave dhe politikave dhe spektër të gjerë faktorësh, ndjekja do të bëhet përmes formularit të përcaktuar të raportit, i cili do të plotësohet nga të gjitha organet përgjegjëse të pushtetit shtetëror.

Për të matur efektet e zbatimit të Strategjisë, është parashikuar një vlerësim afatmesëm (pas vitit të tretë të zbatimit), i cili do të jetë baza për zbatimin e mëtejshëm të Strategjisë.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 9, paragrafi (3) të Ligjit të Mundësive të Barabarta të femrave dhe të meshkujve, do ta ndjek zbatimin e Strategjisë në politikat dhe programet sektoriale.

Kjo strategji do të botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

КУВЕНДИ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Бр. 08-4994/1/  
27 јули 2022 година  
Скопје

№. 08-4994/1  
27 korrik 2022  
Shkup

Претседател на Собранието  
на Република Северна  
Македонија,  
м-р **Talat Xhaferi**, с.р.

Крыетари i Kuvendit  
të Republikës së  
Maqedonisë së Veriut  
Mr. **Talat Xhaferi**, d.v.